

8SH-8

E 35



EDHE
MALET
U ZGJUAN

891.983 - 0

E 35

5

BIBLIOTEKA E RINISË

EDHE MALET U ZGJUAN

(Kushtuar aksionistëve të rrugës
së Malësisë së Madhe)

~~43488~~

12174

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

Përmbledhje vjershash, përshkrimesh etj.
për aksionistët e rrugës së Malësisë së Madhe.

Tirazhi 3000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp NISh Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1967

EDHE MALET U ZGJUAN...

(Në vend të parathënies)

Bjeshkëve të larta të Malësisë së Madhe ju prish qetësia. Ato u zgjuan dhe flakën tej dremi-tjen shekullore. Drejt tyre marshuan ushtria dhe rinia, me kazma e lopata, me vare e baromina; me qysqi e mina, për të hapur rrugën e re.

Melodi të reja shpërthyen atyre anëve: kënga e punës dhe e aksionit jehoi e fuqishme në luginën e Malësisë së Madhe.

Pranverë më të bukur nuk ka parë Malësia.

Kreshtat akoma zbardhëlojnë, por rrjedha e lumit ze e fryhet, shpejton. Dëbora po shkrin.

Në pejsazhin e egër të maleve lindën qytetet e reja me çadra. Në to u strehuan banorët e rinj: ushtarë dhe të rinj bashkë. Ata së bashku do të ndërtojnë rrugën e re.

Është çdo gjë gati; për ngritjen e këtyre qyteteve të maleve, kanë punuar pa kursyer forcat e tyre, repartet e ushtrisë sonë popullore. Në shi, në erë dhe furtunë, në kushte shumë të vështira terreni, ushtarët tanë trima zbritën gjithë materialet e nevojshme, në krah dhe me mushka, që këto qytete të ish-in gati ditën e fillimit të puni-

meve, që vullnetarëve të mos u mungonte asgjë. Edhe këtu u provua qëndrueshmëria e ushtarit, përvoja e komandantit, edukimi i komisarit.

Më 3 prill u hodhën kazmat e para.

Vështirësitë nuk ishin të pakta: puna e vështirë, terreni i rëndë, koha e keqe. Pastaj çdo gjë duhej ta bënin vetë: rregullimin e çadrave, pas-trimin e territorit, mbushjen e ujit, mbledhjen e druve në pyll, shërbimin e rojes e sa të tjera. Dhe këtu u duk figura e njeriut tonë të ri, i edukuar dhe i kalitur nga partia.

Në ujë dhe në zjarr forcohet çeliku.

Në zjarr dhe në flakë çelikoset sot brezi ynë i ri.

Aksioni u bë shkollë e madhe edukimi dhe kalitjeje.

Atje në punë, mbas metrave të para, majë ndonjë shkëmbi ose buzë Cemit lindën dhe fry-mëzimet e para: vjersha, skica, përshkrime. Ata nuk janë shkrimtarë, ndoshta në të ardhmen do të dëgjohen si të tillë. Tashti për tashti ata janë nxënës, punëtorë e fshatarë, që duan të hedhin në letër mbresat e tyre, përshkryjet e vendit, punën heroike për ndërtimin e rrugës.

Këto janë pak shkrime nga vullnetarët e turnit të parë, që punuan, jetuan dhe krijuan në Malësinë e Madhe, për dy muaj rresht prill-maj 1967.

Mensur Hako.

I DASHUR SHOKU ENVER!

Ne të rejat dhe të rinjtë e ardhur në aksionin e përbashkët rini-ushtri, nga zonat e thella të rretheve Kukës, Tropojë, Peshkopi, Burrel, Mirditë, Lezhë, Shkodër, Krujë, Durrës dhe Tiranë, të mbledhur në një takim me shokun Petrit Dume, ju dërgojmë përshëndetjet tona revolucionare, të pas-tra si zemrat tona rinore, si era e maleve të bjeshkëve tona.

Ne hapim rrugën e re në Malësinë e Madhe, aq të dashur për kooperativistët e këtyre anëve, për të përhapur dritë e begati në skajin më verior të atdheut tonë.

Në të kaluarën, kjo ishte një ëndërr e porealizueshme dhe vetëm sot, këtë ëndërr, partia jonë po e kthen në realitet.

Ne jemi krenarë dhe entuziastë që të parët hodhëm kazmat dhe prishëm qetësinë shekullore të bjeshkëve të veriut.

Duke e çmuar aksionin si shkollë të madhe edukimi dhe kalitjeje për brezin e ri, si na mësoni Ju, shoku Enver, krahas punës për hapjen e rrugës, zhvillojmë një aktivitet të gjërë politik-edukativ dhe kultural-sportiv.

Kemi arritur suksese të mëdha në punën tonë, por ne nuk jemi nga ata që kënaqemi me kaq, sepse vëmë re që kemi edhe të meta, hasim edhe vështirësi.

Ne ju sigurojmë, shoku Enver, se këto mungesa do t'i zhdukim dhe porositë, këshillat, që na dha shoku Petrit, në emrin e Komitetit Qendror dhe Tuajin personalisht, ne do t'i vëmë në jetë, do të punojmë me frymë revolucionare si bij dhe bija të denjë të prindërve tanë. Për këtë ne punojmë dhe jetojmë me organizim, disiplinë dhe temp ushtarak, kapërcejmë vështirësitë, duke vënë të gjitha fuqitë tona fizike për realizimin e detyrës sonë në aksion.

Të frymëzuar nga hovi i madh revolucionar që ka shpërthyer në të katër anët e atdheut tonë dhe për nder të zgjedhjeve dhe të Kongresit të V-të të B.R.P.SH. angazhohemi:

1 — 20 ditët e fundit të turnit tonë në aksion, t'i shpallim ditë sulmi.

2 — Rinia shkollore vendosi që ditën 7-orëshe të punës ta kthejë në 8 orë dhe të ngrejë normën nga 1.3 m. kub. në 1.7 m. kub.

3 — Rinia e shkollës «Qamil Gjuzi» të Rrogoshinës e ngriti në 2.2 m. kub.

4 — Rinia punëtore dhe fshatare vendosi të ngrejë normën nga 1.7 m. kub, në 2 m. kub.

5 — Do të punojmë dhe do të luftojmë akoma më shumë kundër të gjitha zakoneve prapanike, mbeturinave në ndërgjegjen e njerëzve, duke përdorur për këtë biseda, takime, çfaqje dhe koncerte të ndryshme dhe duke përhapur fletërrufetë.

6 — Mësimet që kemi marrë dhe do të marrim nga jeta dhe puna në këtë aksion, do t'i përhapim

gjërësisht në shkollat dhe qendrat tona të punës dhe prodhimit.

Ju premtojmë, shoku Enver, se zotimet tona do t'i bëjmë realitet, do të mbajmë lart emrin tonë si rezervë luftarake të partisë sonë të lavdishme, do të çojmë dhe më tej stafetën e revolucionit, duke patur kurdoherë parasysh parullën e partisë: «Në një dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën», do të ecim gjithmonë përpara duke punuar, duke mësuar dhe duke vigjiluar.

Me këtë rast, ju urojmë Juve, shoku Enver, mësues dhe udhëheqës i partisë dhe i popullit tonë, shëndet dhe jetë të gjatë.

**NGA VULLNETARËT E RRUGËS
SË MALËSISË SË MADHE.**

JU PËRSHËNDESIM DHE JU FTOJMË NË GARË

Të dashur shoqe dhe shokë vullnetarë të aksionit të rinisë Rrogozhinë-Fier!

Ne, vullnetarët e aksionit të rrugës së Malësisë së Madhe, sot, pasi hapëm metrat e para të rrugës së re automobilistike, vendosëm t'ju dërgojmë juve përshëndetjet më revolucionare rinore.

Të ardhur nga Tropoja, Kukësi, Shkodra, Durrësi, Burreli, Lezha, Peshkopia, Kruja, Mirdita së bashku me vëllezërit tanë ushtarë, ne do të punojmë me të gjitha forcat që të hapim këtë rrugë, e cila do të ndihmojë për të çuar më shpejt në bjeshkët kreshnike të Ded Gjo Lulit dritën e së resë revolucionare, që shpërtheu më me vrull pas Kongresit të V dhe fjalimit historik të shokut Enver para disa organizatave të partisë së Tiranës.

Jemi shumë të gëzuar, sepse në këto vende të thella malore gjetëm të pastër mikpritjen tradicionale të malësorit, për të cilën kemi kënduar dhe lexuar shpesh. Burra e gra, pleq e të rinj, pionerë dhe fatosa si për festë ishin grumbulluar në të dy sektorët dhe me çiftelitë gazmore dhe vallet dinamike, shprehnin gëzimin e tyre për arritjen tonë.

Sot, këta malësorë mikpritës me kazma e lo-

pata në krahë zbritën malin dhe u shkrinë në vargun tonë të gjatë për të dhënë kontributin, e tyre në këtë aksion që na besoi Partia.

Me thjeshtësi mund t'ju themi se dita e parë e punës, megjithëse e vështirë, shkoi shumë mirë. Të bukura do të jenë dhe çastet kur në orët e pasditës fyelli e çiftelia, kitara e fizarmonika do të këndojnë për punën dhe për jetën tonë të re kolektive.

Sot brigada e Shkodrës dhe nesër ajo e Durrësit vendosën që me forcat e tyre të japin për ne programe artistike, duke u bërë kështu shkëndija e gjallërimit të jetës kulture-artistike.

Ne mendojmë t'ju ftojme në garë për rezultate sa më të larta në punë për organizimin sa më të mirë të jetës kulture-artistike dhe për ndihmë më të madhe në luftën kundër zakoneve prapanike e paragjyqimeve fetare dhe për forcimin ekonomik të kooperativave të fshatrave përreth.

Megjithëse larg njëri tjetrit dhe në fronte të ndryshme pune, forcat, mendimet dhe ndjenjat tona i bashkon një qëllim i lartë: ndërtimi i dy veprave të rëndësishme të 5-vjeçarit IV dhe kalitja jonë ideopolitike e fizike, duke vënë kështu në vend porosinë e udhëheqësit tonë të dashur, shokut Enver.

Duke e përfunduar letrën tonë miqësore, ju urojmë shëndet dhe punë të mbarë në aksionin tuaj.

Përshëndetje revolucionare.

**VULLNETARËT E AKSIONIT TË RRUGËS SË
MALËSISË SË MADHE**

JU PËRSHËNDESIM DHE SOLIDARIZOHEMI ME GARËN

Të dashur shoqe dhe shokë vullnetarë të aksionit të rrugës së Malësisë së Madhe!

Me kënaqësi të madhe lexuam përshëndetjen tuaj. Ju kthejmë juve, shoqe dhe shokë vullnetarë të dashur, përshëndetjet tona më revolucionare.

Edhe ne të 5200 vullnetarët, të ardhur nga të katër anët e atdheut, kemi disa ditë që, duke vazhduar punën e shoqeve dhe të shokëve tanë të turnit të parë, po punojmë me hov revolucionar për ndërtimin në afatin e caktuar dhe me cilësi të lartë të hekurudhës së rinisë Rrogozhinë-Fier, të kësaj vepre të madhe të pesëvjeçarit të katërt që na besoi partia.

Ne, shoqe dhe shokë vullnetarë, ndonëse punojmë në fronte të ndryshme pune, kemi të njëjtin qëllim: lulëzimin e mëtejshëm të atdheut tonë socialist dhe kalitjen tonë të mëtejshme revolucionare.

Këtu në aksion, ne e ndjejmë veten shumë të gëzuar. S'ka se si të jetë ndryshe, kur punon për një qëllim kaq të lartë.

E mbushur nga aktivitetet nga më të ndrysh-

met kalon jeta jonë gjatë kohës së lirë. Ne herë pas here zhvillojmë biseda për kalitjen tonë ideologjike dhe politike. Në të katër sektorët, ku ne jetojmë dhe punojmë çdo ditë, gjatë kohës së lirë ushtojnë këngët tona të bukura. Grupet artistike të brigadave argëtojnë vullnetarët herë pas here. Terenet sportive mbushen çdo ditë nga skuadrat e brigadave që konkurojnë ndërmjet tyre. Me eskursionet dhe me vizitat nëpër qendrat e ndryshme industriale dhe në kooperativat bujqësore të rrethit, ne po njihemi më nga afër me përparimet që ka bërë Lushnja gjatë viteve të pushtetit popullor, njihemi më nga afër me jetën dhe punën e fshatarëve dhe punëtorëve tanë, mësojmë prej tyre, forcojmë miqësinë me ta.

Një pjesë e mirë e vullnetarëve kanë ardhur nga zonat malore të vendit si nga Kukësi, Tropoja, Puka, Burreli etj. Shumica e tyre janë të reja të ardhura nga kooperativa të porsakrijtura. Me to bëhet një punë e mirë për njohjen e tyre me kooperativat e përparuara të rrethit të Lushnjës. Një punë të mirë bëjmë ne për luftën kundër zakoneve prapanike, kundër paragjykimeve fetare dhe për ngritjen e personalitetit të gruas dhe të së resë shqiptare, me anë të bisedave që janë zhvilluar dhe zhvillohen vazhdimisht. Në të gjithë punën tonë ne udhëhiqemi në çdo hap nga vendimet e Kongrest V të P.P.SH. dhe nga fjalimi i 6 Shkurtit i shokut Enver.

Ne, vullnetarët e hekurudhës së rinisë Rrogoshinë-Fier, me gëzim të madh i përgjigjemi garës që na shpallët ju, duke e vlerësuar këtë si një nxitje të mëtejshme për ndërtimin në afatin e caktuar të këtyre dy veprave të rëndësishme të 5-

vjeçarit të katërt.

Ne dëshirojmë gjithashtu që të kemi lidhje të vazhdueshme me anën e letrave për shkëmbimin e përvojës sonë në punë, për njohjen me jetën dhe me punën e njeri tjetrit.

Duke përfunduar letrën tonë, ju urojmë shëndet dhe punë të mbarë.

Përshëndetje revolucionare

**VULLNETARËT E AKSIONIT TË
HEKURUDHËS SË RINISË
RROGOZHINË-FIER.**

KONGRESIT V TË RINISË

N'ato bjeshkë-o kah malcia
Buçet kanga e çiftelia,
Shpërthen vrrulli dhe hareja,
Hapen rrugë e toka t'reja.
Në një vend ku s'ec' as dhia,
Xhade t're po ban rinia,
Kjo rinia dhe ushtria.
Ushtojnë grykat dhe luginat
Çahet shkëmbi nga minat.
O rini, që në ball marshon,
Fitimtare në çdo aksion,
Edhe sot në të madhen festë,
Në kongresin tand të pestë,
Delegat' erdh' prej aksionesh
Në këtë kongres të madh fitoresh.

Gëzimet tona e kanë burimin
Që nga lufta për çlirimin,
Që nga dita e krijimit
E Partisë, themelimit.

Sot partisë i japim besën:
Do t'jetojmë vetëm me djersën,
Do ta çojmë para stafetën.
Në rast nevoje për të vërtetën
S'do kursejmë gjakun as jetën.

KËNGA E RRUGËS SË MALËSISË SË MADHE

U nis brigada jonë
Nën marshin partizan,
Përpara prin flamuri,
Si diell që shkrep mbi mal.

Një rrugë të re do hapim
Në malet legjendare,
Ne forcat nuk na shterin,
Ne jemi vullnetarë.

Do shkojm' në bjeshkët tona
Me hov e vrull rinor,
Ku shqipja jonë ngre çerdhen
Në majat plot me borë.

Atje ku thot' Partia
Të gatshëm, plot guxim,
Do hapim shtigje të reja
Me vrull' e plot besim.

KËNGË FITIMTARE

U rrjeshtuam në brigada vullnetare
Dhe me hapin krenar parakaluam
Të hapim rrugën e Malsisë së Madhe.

Këndeje, viganin e gurtë tufani s'e theu,
As shiu s'e breu.
Ne po ja ham' zemrën me hekur e qysqi,
Se jemi rini,
Më të fortë se ai.

Kazmat e çelnikta shkrepin mbi shkëmb,
Ato janë shkënditë e vrrullit tonë.
Copa shkëmbi mbajmë mbi supe e i flakim në hon;
Kështu flakim ne çdo mbeturinë.
E kush matet me rininë,
Që çan në rrugë të reja, të vjetrën tek shemb?

Ky është vrulli ynë,
Vrulli djaloshtar.
Ne s'kemi shumë mjete:
Një kazmë, një pushkë
Dhe historinë e Partisë, fanar.

BRI RRUGËS SË VJETËR NJË RRUGË E RE...

Çdo ditë shoh metrat e trasesë,
 që rriten me shpejti,
 çdo ditë shoh se si përplasen mbi shkëmb
 dhjetra e mijëra kazma,
 shoh si mposhtet i pafuqishëm mal' i tërë,
 nga gjokset e tu plot zjarr, o rini.

Ja, këtu bje ngadalë një pemë,
 atje tundet toka nga goditjet,
 pas pak shpërthejnë minat pa ndërprerë,
 çdo gjë që ish më parë zhduket, venitet.

Bri rrugës së re, që zgjatet dita-ditës,
 rrug' e vjetër, ndërtuar shumë koh' më parë.
 Ajo, para së resë që përtëritet,
 nuk është veçse një kapilar.

E ndjej djersën që më rrjedh nga balli,
 por kokën për asnjë çast nuk e ngre,
 për metrat, për zgjatjen e trasesë,
 për te veç mendoj, veç për te.

Armatat e të rinjve do ndërrojnë njera tjetrën
 E rruga do zgjatet, mes bjeshkësh do kalojë.
 Ndër dejt' e Malësisë do rrjedhë gjak i ri,
 Kudo, këng' e jetës e vrullshme do t'ushtojë.

DËGJO, O CEM.....!

Dëgjon, o Cem,
 ç'dëshirë më vlon në gji
 tani që thur këtë poezi..
 Më fal nëqoftëse them të vërtetën,
 se frymëzim s'lypa tek ti.
 Jo! Këta ujë, që rrjedh kristal
 e gurgullon mes gurësh me furi,
 s'do më dehë me fantazi
 e romantizëm këtë radhë.

Dëgjo, dëgjo, o Cem krenar,
 si mbytet oshëtima jote,
 nga zhurma e kazmave që çajnë
 shkëmbinjtë e fortë shekullorë.
 Dëgjo si zjen Malësia e Madhe
 nga këngët tona gëzimplote,
 E prit në gjirin tënd
 këta shkëmbinj, që muskujt tanë
 me djersë i lajnë e t'i dërgojnë
 që ti t'u bësh aty pak vend.
 Se veç tek ti do mund të shuajnë
 zjarrin që ndezin parreshtur,
 nga kazmat që rrahin me vrull e fuqi
 tokën shkëmbore, me shkurre veshur.
 Ndërtojmë çdo ditë me gaz e durim
 rrugën e re nga Hoti n'Vermosh.

KËSHTU E FILLUAM NE....

Kështu e filluam ne,
Në mes të uturimës së lumit që rrjedh me furi,
Në mes të shkëmbinjve që ngrihen gjer në re!

E filluam me vrull rinor,
Me gjoksin e hapur përpara stuhisë.
Flamuri i kuq na ndriste në dorë!

Kënga jote arrinte në bjeshkët e larta,
Përshëndetje i jepnim ne Partisë.
Përshëndetje të ëmbla nga zemra të zjarrrta...!

GËZIM TË MADH KA SOT MALËSIA

Gëzim të madh ka sot Malësia:
Rrugë të re ndërton Rinia.
Po ushtojn' sot fusha e male,
Hapet rruga e Mal'sisë së Madhe.

Po kush vjen sot në aksione?
Vjen e reja prej Tropoje,
Vjen nga Lezha e Burreli,
Vjen nga Shkodra, Dibra e Rrësheni,
Vijnë nga Kuksi e rrethe të tjerë,
Sikur lulet në pranverë.

E çfar' isha un ma parë?
Një malsore e pashkollë.
Sot gjithshka ka ndryshue,
S'mundem gazin me e diftue.

Të gjitha të mirat që na gëzojmë
Ty, Enver, na t'i kushtojmë
Rrofsh sa malet, prijs gjithmonë,
Të falshim ditë nga jeta jonë...

RRUGA E RE.

Dhe Shqipëria buzëqesh
me buzëqeshjen e saj të dlirtë,
se nesër,
nga gjokset rinore,
në arterin vigan
të Malësisë së Madhe
gjak të kuq, të pastër do të shpjerë...

Dhe Cemi gurgullon,
rrjedh vrullshëm dhe s'ndalet,
ecën, ecën, vetëm ecën
si vetë jeta jonë,
si vetë kënga jonë...

Dhe puna vazhdon,
dhe rruga çdo ditë rritet,
hedh shtrat
si nuse me duar vogëlushe,
e stolisur
me kazma, lopata,
që ne mbajmë në duar.

Dhe lumi rrjedh,
Dhe kënga buçet,
Dhe puna vlon...!

RRUGA E MALËSISË SË MADHE.

Kjo Partia zemërgjanë
Na suell ndihmë nga çdo anë.
Rinia jonë vullnetare,
Në këto male buz' kufinit,
Po hap rrugn' e Malësisë s'Madhe.

Në këto male dhe lugina,
Mbush me radio, mbush me drita,
Nuk dim' gja me e dallue:
Thue në Tiranë je tue shkue.
Këtu, n'aksionin e Malësisë,
Ka rini prej krejt Shqipnisë.
Do ndërtojm' rrugn' e makinës
Nën udhëheqjen e Partisë.

Unë, e reja e ktij katundi,
Nuk gjej fjalë me ju diftue;
Kur e shoh fshatin tim
Që asht mbush plot me gëzim.
Kooperativë na jemi formue,
Jetë të re kena fillue.
Pleqtë tanë bajnë çudi
S'kan' besue se kan' me mbrri
Rrugë makine këtu me pa,

Jetë të lumtun kurrë s'kan' ba.
Por jan' të gëzuem sot në pleqni,
Kur e shohin kte rini
Tue ndërtue vendin, bukuri

Kur ndiej pleqtë e këtij vendit
Qi tregojn' vuejtjet e Kelmendit,
Gjithmonë n'padie e mjerime,
Tue u vra e tue plaçkitë,
S'i kan' la me pa kurrë dritë.

Ne, rinia e Kelmendit,
Kem' zbatue Fjalën e Partisë
Me i dhan' dritë Malësisë,
Jetë të lumtun në çdo anë.
Rroftë për jetë Partia jonë
Me Enverin që e drejton.

LUM E LUM PËR TY, PARTI!

Lum e lum për ty, Parti,
Ç'po e kalit brezin e ri,
Po punon sot kjo rini
Anemban' nëpër Shqipni,
Po çon dritë dhe hijeshi.

Mbas Kongresit të Partisë,
Ju drejtove ti rinisë
Me ju ngjitë maleve të Shqipnisë.

Shqipnisë pamjen t'ja ndryshojmë,
Në një dorë kazmën, n'tjetrën pushkën,
Ta bëjmë malin porsi fushën,
Në çdo vend t'sigurojm' bukën.

Viti dytë i pesëvjeçarit,
Të gjitha punët jan' për së mbarit:
Në Vermosh, në male t'Skraparit,
Në Rrogozhinë e n'asht t'Cukalit
Ushton puna e vullnetarit.

Edhe një herë Partis' i premtojmë
Se aksionet që do t'na besojë
Me sukses do t'i mbarojmë,
S'tutemi kurrë prej fjalës sonë.

VALËT E CEMIT...

Poshtë gurgullon Cemi,
lart punojmë ne,
I dhurojmë Malësisë
rrugën ton' të re.

Kënga e të rinjve
përzihet me hare
dhe në Alpet tona
sjell jehonë të re.

Valët e Cemit ndjekin
njëra tjetrën me nxitim,
por këto valë të lumit
vrullin tonë s'arrijnë.

NDËR KËTO MALE TË MALËSISË...

Ndër këto male të Malësisë
Ushton kënga e rinisë,
dhe pranvera me të del
shum' ma shpejt se tjera herë.
Lum po ban populli i Grabonit,
i Tamarës, i Vermoshit.
Çka na sjell ky pesëvjeçar?
Sjell makinën me udhëtue,
sjell traktorin me punue.

Ja ç'i thotë e reja shkambit:
«Çaju shkamb, se këtu s'ke vend,
shko e gjeje vendin tand,
këndej makina do t'kalojë,
gjithë Malësinë do ta përshkojë,
se do gëzohen pleq e fëmija,
kur t'ndigjojn si bjen buriija.»

Ja dhe Cemi tek asht ndalë,
me ju thanë nja dy fjalë:
«Në shekuj jam tue udhëtue,
se s'ka mujt kush me m'turbullue,
veç sot ju më ken' hutue.»

Ç'po ushtojnë leqet e Hotit,
pëlçet mina prej barotit,

nga ushtarët e sektorit.
Dhe armiku në kufi
po pëlçet nga cmiri i zi,
Dhe malësori kur kalon,
ne nga zemra na uron:
«Rrofsh për jetë, o moj rini,
përparofsh, o moj ushtri,
bukur ju prin nana Parti.»

BETEJA ME SHKËMBIN

Ç'më rrika ky shkëmbi i vrerët.
Ë shoh të dërmuar, të vrarë.
Oh, i shkreti, si ka mbetur!
Me të po ndodh diçka e paparë.

Kur i afrohem me kazmë në dorë,
me vërejtje rri duke e shikuar.
Ai paska marrë vendim të prerë
gjer në fund për të qëndruar.

Shkëmb, o shkëmb, ti do të thyesh,
më kot mundohe të jesh krenar.
Këtu, në këmbët e mia do biesh,
nga vrulli ynë i paparë.

Dëgjo, i them, tani mbarove.
A nuk e sheh forcën tonë, o shkëmb ?..
Këtu ku je ti rruga do kalojë,
prandaj dhe unë dua të të shemb.

Hapu nga rruga, më nuk të them,
sepse të bëj copë e thërrime.
Ai vend ku je ti mua më duhet:
Atje do kalojë rruga ime...

BRI RRUGËS NJË LAPIDAR...

Për ju, o dëshmorë,
Unë sot vjershën time
do të thur,
Se ju më ngjallni në zemër kujtime,
Që nuk shuhen kurrë.
Jeta juaj plot lavdi
Na ndrin përpara
si fanar,
Se të shpalosur
ne e mbajmë
Flamurin tonë proletar.
Andaj sot kjo kënga ime
Plot vrull shpërthen
Për ju, dëshmorë.
Një tufë lulesh
betimin tonë
Mbi varin tuaj po e vemë.
Lavdi,
Lavdi,
Për jet e mot,
Lavdi ndër shekuj, o dëshmorë
Sot,
të gjithë ne,
Për kujtim,
bri jush
Po hapim
edhe një rrugë të re

DUART ME DAMARË

I shoh përherë unë ato dy duar
të mëdha, të ashpra, plot nyje e damarë,
I shoh me etje e ndjehem e gëzuar,
Më të bukura duar jo, unë nuk kam parë.

E lumtur ndjehem kur lexoj diçka.
Të lumtur më bën e ëmbla melodi,
Por lumtëri më të madhe për mua nuk ka,
Kur duart me damarë i shoh përsëri.

Kudo mund t'i shohësh duart me damarë,
Me çekiç, mes hekurash, në makineri.
Me llaç përzjerë, tullat vënë me radhë,
Pa u lodhur kurrë në çdo vështirësi.

Më pëlqen t'i zë duart me damarë,
Në grushtet e mi të njomë t'i shtrëngoj,
T'i pushtoj fort me afsh e me zjarr,
E për to gjithmonë të këndoj.

NË MALËSINË E MADHE

Nisëm ndër rrugët e tua marshimin, socializëm.
Rinia

Ecën e vendosun

Ndër shtigje të reja!

Ngjitemi ndër male, pllaja e kodrina

E n'zemër shkambit i vemë mina.

Jemi ngritë na brezi i ri!

I ri asht punëtori, i ri mendimi, e re koha

Zani i së resë, ndigjohet kudo

U përmbys e vjetra, vumë themele të reja

Në Malësinë e Madhe drita do të shkojë

E vala e lumit do të urdhnohet

Njeriut t'i nënshtrohet!

Në veri të Shqipnisë me maqina do të shkojmë

E shinat e hekurta deri në Fier po i shtrojmë...

Ecim ne për tek ti, socializëm,

Tue mbajtë në një dorë kazmën e në tjetrën

pushkën.

Rojet në kufi, Shqipni, për ty rrinë,

Ushtarë të zotët, që çajnë në suferinë.

Udhën për tek ti po hapim, socializëm.

Kemi në krye Partinë e Punës

E mësuesin ENVER

Në ballë të furtunës!

LAMTUMIRË!

Nënë! Më dëgjo:
Ne po shkojmë të mundim malin
Dhe një rrugë do ndërtojmë!
Mirë u pafshim!
Kur të kthehem,
Do jem m'i sjellshëm
Se atje ku vete unë
Ndërgjegja të tërheq veshin.

Lamtumirë dhe ju, muret e shtëpisë!
Lamtumirë dhe ti, shtrati i nxehtë,
Do shkoj atje, përpara stuhisë,
Ku era e ftohtë të mpin fytyrën,
Atje ku gurët pëlcasin nga të ftohtët!
Do shkoj të kalitem,
Që të jem i gatshëm
Çdo armiku t'i përgjigjem!

ECËN NJË MALËSOR.

Hapim rrugë të re...
Ecën një malësor
e don me kujtue
rrugën e ngushtë,
ku dikur me mushkën
pat' kalue...
Ku është ajo ferrë,
ku pallton kish grisë disa herë?
Ajo gropë
ku mushka ish rrëzue?
Ku asht ai shkamb,
kur i lodhun u ul me pushue?!
Ecën një malësor,
ne hapim rrugë të re:
mbi shkëmb një trase.

SHKATARRAQI...

(Satirë)

Në mëngjez kur ngrihem,
Vallë ç'të bëj më parë?
Nuk i gjej dot sendet,
S'di kush m'i ka marrë.

Ku e kam gavetën,
Që aq shum' e dua?
— Hedhur në një qoshe
Te këmbët e tua...

Shallin nuk e gjej,
S'di ku e kam lënë.
— Si këllëf jastëku
Mbrëmë e pate vënë.

Krevatin në çadër,
E kam lën' rrëmuje.
Po kërkoj pagurin,
Që ta mbush me ujë.

Në thirrjen e mbrëmjes
S'paraqitem fare.

Më pa komandanti,
Më bëri një pare.

Kush është si unë,
Me gjith' këto halle?
Por kjo nuk është punë,
Duhet të ndryshoj fare.

KËMBELIT

Pres një çast me padurim,
Lajmërimin për pushim:
T'hedh lopatën pa përtim
E t'gjej hijen për t'u shtrimë.

Dhe pastaj bie në gjumë
S'luaj vendit, dhe t'bëj bum.
Dhe kur puna të fillojë,
Askush s'guxon të më çojë.

Gjithnjë në mbledhje kritikohem,
Me tërë gabimet unë mbulohem,
Shpejt e shpejt bëj autokritikë,
Sikur të bëja gjimnastikë.

Por ksaj radhe, shok, kam ngec
E po dridhem si karkalec,
Me litar sikur m'kan' lidhë
E nuk ka se kush të m' zgjidhë.

Por unë, shokë, ju premtoj
Që sot e tutje do t'punoj
Dhe kurrë më s'ju shqetësoj,
Se tani drejt ju kuptoj...

GJITHMONË KËSHTU NA ARDHTE PRANVERA!

Pranverë më të bukur nuk ka parë Malësia. Dëbora po shkrin. Së bashku me rrjedhën e ujit, që zbret nga mali, erdhët edhe ju. Me cicërimën e zogjve të pyllit u përzie dhe melodia e këngës suaj. Ngjyra të reja sollët në këto anë. Njerëz të rinj ndërtojnë veprën e re. Erdhët ju të mundeni me shkëmbin. Dhe po e mundni atë. Po fitoni mbi të. Para syve të mi, ju jeni më të mëdhenj, jeni fitimtarët e betejave, ndaj ju nderoj më shumë, ju dua më shumë.

Valle në kohën e lirë.

Jeta e aksionit është e gjallë, e larme, e rrëmbyeshme si vetë rinia. Erdhën nga anë të ndryshme, por të lenë përshtypjen se njihen prej kohësh. Qëllimi dhe ideja i bashkon.

Bie çiftelia. Hiqet vallja me të shpejtë. Fytyrat e vullnetarëve janë të qeshura. Rrethi zgjerohet. Të gjithë duan të hyjnë në valle. Edhe një vajzë matet të hyjë; por prapë nguron. I vjen turp, por zemra ja do të kërcejë dhe ajo vallen, që aq mirë ja thotë. Ja lexoj në sy dëshirën. E shoh që

bën një hap përpara, e unë me mendje them: «Hyri», por ajo prapë tërhiqet. Në fshat ndoshta nuk e ka kërcyer ndonjëherë vallen me djemtë.

Dikush e shtyri nga mbrapa e ajo u gjend në rrethin e valles. Vullnetari i fundit e kapi për dore, e hapat e saj hidhen me ritmin e të tjerëve. Skuqet në fytyrë. Përfytyron fshatin. Çka do të thonin ata po ta shikonin?

Bjeri çiftelisë, or djalë! Më shpejt, më shpejt hiqe vallen ti, cuca e maleve.

Të martuarit

Diçka më shtyn të shkruaj për çiftin e ri. E kam jetuar fshatin, i njoh së afërmi zakonet e tij, që ja la trashëgim bota e perënduar, ndaj nuk mund të rri pa i sjellë ndër mend ato skena dramatike, që më kanë mbetur në kujtesë si gjurmë të një rruge të errët, nëpër të cilën kaloi vajza apo nusja e zhveshur nga personaliteti i saj shoqëror.

Sa gëzohem sonte që në rrugën e dy të rinjve ndriçon një dritë e madhe, e fortë. Është drita që solli Partia.

Nuk ka qetësi në kampin e vullnetarëve. Radio kudo. Mbi një shkëmb, në breg të lumit, janë ulur disa vullnetarë e po i bien fyellit. Në sheshin e vogël të tjerët po vallëzojnë. Në oborrin e ngushtë dhe të gjatë të çadrave dalloj dy vullnetarë. Ecin ngadalë e fjalosen. Zef e quajnë atë. Është nga fshatrat e Shkodrës. Nuk ka shumë kohë që u martua me Luçijen. Vendosën ta thyejnë zakonin. U regjistruan vullnetarë. Po, ai djalë vigan që

derdh forcën e tij në punë, si mund të tërhiqej nga zakoni? Ajo dorë e fortë si të mos e shkatërrtojë atë zakon që përpëlitet në agoni?! Dhe ai i shkeli zakonet prapanike. E prishi aksioni zakonin. Nuk ka më për çiftin e ri ecje për një me disa metra largësi (kuptohet, burri përpara, bile me kryet lart, e gruaja mbrapa, e kërrusur nga pesha e barrës mbi shpinë).

Jam prej Dukagjini

Copa e rëndë e hekurt përplaset me forcë mbi barominë, të cilën e mbajnë dy duar të forta. Shikoj me dashuri dhe frikë vajzën që, herë pas here, godit me gjithë forcën e saj. Një lëvizje gabim dhe duart e shoqes...

Më bëjnë përshtypje tiparet e gjalla të kësaj vajze malësore.

— Nga je, moj vajzë?

— Jam prej Dukagjini, foli ajo dhe vazhdoi punën me ritmin e parë.

Në përgjigjen e saj dallova krenarinë. Nuk e njeh më ajo kanunin e Lekës. Njeh fjalën e Partisë, shtigjet e reja për vajzën e re, dhe ka guxim të kalojë nëpër ato shtigje.

— Katerina punon shumë, thotë për të Xhyherja, vullnetarja që shkoi të punojë dhe të jetojë dy vjet në Dukagjin. — Ditën e parë ndoqi me kujdes vendosjen dhe ndezjen e minave. «Dua të bëhem minatore», tha ajo papritmas, por e vendosur. Në fillim e shikuam me dyshim, por një ditë ajo hodhi shkëmbin në erë. Kjo ishte prova për minatoren e re. Dhe ne i besuam asaj.

— Po ajo vajzë që sheshon dheun?

— Është nga fshati Lotej i Dukagjinit, E quajne File. E para vullnetare që u regjistrua. Megjithëse që e fejuar, erdhi në aksion. Kurse Mrija, vazhdon Xhyherja, këtu punon bashkë me të kuzin, Nikën. Atje e kanë për turp t'i shohin një-ri-ri e të fejuarit, kurse këtu punojnë krah për krah.

Filja dhe Mrija: dy vajza të fejuara. A nuk janë edhe këto minatore?. A nuk e hodhën edhe këto në erë zakonin-shkëmb?

Eci edhe më duket se më tingëllon në vesh përgjigja krenare: «Jam prej Dukagjini».

Ida, sa shumë ke ndryshuar!

Nuk të njihja më parë, Ida. Veç shokët e tu më thanë që je rritur me përkëdhelje. Të vinte rëndë të ndihmoje edhe nënën në shtëpi. Çdo gjë e doje gati. Edhe bukën, edhe gotën e ujit, edhe këpucët. Të ndihmuan sa herë shokët, shoqet, por nuk u korigjove. Ti erdhe në aksion. Askush nuk të besoi se do të punoje. Por ti shokëve u pregatite një të papritur të bukur. Duart e tua të vogla shtrënguan kazmën. Sa e rëndë t'u duk ditën e parë!. T'u formuan fluskat e para, por kazmën nga dora nuk e lëshove. Ti deshe ta mbash lart nderin e kompanisë. Dhe po e mban. Brigada e shkollës flet me dashuri për ty. Je një nga vullnetarët më të dalluara në punë. Shoh se shkrepin shkëndija nga përplasja e kazmës sate mbi shkëmb. Balli të është mbuluar me djersë. Dhe unë të dua shumë, Ida, të dua për punën tënde.

— Ida!

Ti kthen kryet. Për një çast ndërpret punën.

— Shkëmbi është i fortë...

— Por ne jemi më të fortë se ai...

— Çka do t'i thuash nënës, kur të shkosh në Durrës?

U skuqe në fytyrë. Duket e kuptove që unë dija diçka për ty, por menjëherë e more veten dhe u përgjegje:

— Do t'i them që në aksion u mësova me punë.

Po, Ida, ashtu thuaji, të vërtetën.

Vajza nga Tropoja.

Një erë e lehtë përkundi degët e pemëve. Jehona e këngës ushton në luginë e shoqëruar me krismën e kazmave në shkëmb. Një bajonetë shkëlqen në rrezet e diellit. Dy duar vajze shtrëngojnë pushkën. Qëndron mbi shkëmb e shikimin e ka hedhur larg. Ai shkëmb i duket piramidë. Kujton ushtarin. Edhe ai kështu bën roje. Puna dhe kënga nuk ndërpriten. Liza vigjëlon. Sa hije i ka pushka! A thua se ka lindur me të në krah.

Komandantja e brigadës.

Një flamur shpaloset mbi shkëmb. E mban brigada «Manush Alimani» e Shkodrës. Anëtarët e brigadës punojnë me ritëm të shpejtë. Gurët rrokullisen poshtë me zhurmë. Në krye prin Prendusha. Punon me tërë forcat, nuk pyet për djersën,

as për kallot ndër duar. Nuk lodhet Prendusha, e njoh unë atë. Është nga Mjeda dhe erdhi në aksion me gjashtë shoqet e reja të estradës së fshatit. Kalon sa në një skuadër në tjetrën. Punon, jep udhëzime, kontrollon punën, por në fund nuk harron t'i porosisë shokët për aktivitetin kultural të mbasditës. Kanë vendosur të marrin flamurin, megjithëqë konkurentët i kanë shumë të fortë.

— Si thoni, shokë, a do ta mbajmë ne flamurin e sektorit?

— Nuk e dorëzojmë, shoqja komandante! Skeçet i përgatitëm dhe i mësuam.

Edhe rapsodi e bëri punën e tij.

Kjo do të jetë e pesta çfaqje, që po jep rinia fshatare e brigadës së Shkodrës, me komandante brigade Prendushën.

Nga epruveta tek shkëmbi.

Përfytyroj Dritën, të veshur me bluzë të bardhë, duke ndjekur reaksionin që lind në epruvetë. Gishtat e saj kapin lapsin, e diçka shënon në letër. Vëmëndjen e ka përqëndruar brënda xhameve të laboratorit.

Shof Dritën sot. Drejtohet për tek fronti i punës. Bluzën e bardhë e ka zëvendësuar me pantallonat dhe shallin e aksionit, lapsin me kazmën, laboratorin me ashpërsinë e maleve, epruvetën me shkëmbin, lëndën reaktive me dinamitin, reaksionin me hedhjen e një shkëmbi në erë, kalkulimet përfundimtare të provës me hapjen e rrugës. Në bluzë mban inicialet D.H. Sot në gjoks mban katorin e kuq «S».

O miqt e mi!

Erdhët nga anë të ndryshme. Ju pret Malësia me bujarinë e saj shqiptare. Ju sollët freskinë rinore, këngën e jetës së re. Ju jeni vullnetarë që vini nga shkolla dhe fshati.

Ushtojnë malet nga shpërthimi i minave dhe kjo është kënga juaj më e fuqishme që ndigjohet deri larg. Ja, një plakë malësore është ndalur pranë jush. Harroi që mushka e ngarkuar i kaloi larg. Mundohet të dallojë vajzën e vet midis vullnetarëve. Por ju i dukeni të gjithë njësoj.

— Si të duket kjo punë, o gjyshe? — i thashë kur i dhashë dorën.

Ajo më pa me vërejtje këpucët dhe pantallonat e mia, pastaj më tha:

— M'vjen keq, oj bijë, që u plaka. Veç mos deksha pa hypë një herë në makinë.

Fjalën e ndërpreu. Hodhi sytë tek vullnetarët. U mallëngjye, më vuri dorën në shpatulla e më tha:

— Erdh Partia, erdh behari, bijë!

DITËT E PARA.

I.

Ishte festë e madhe për fshatarët kooperativistë të Malësisë së Madhe, dita kur në vendin e tyre u duk kolona e gjatë e vullnetarëve, të veshur me kostumet e tyre të punës. Me zemër të gëzuar, ata dolën për t'i pritur vullnetarët. Dhe vullnetarët, të rinj dhe të reja, fshatarë dhe qytetarë, nxënës të rinj me zemra të zjarrita, prunë në vetë gjallërinë djaloshare, vrullin revolucionar, besimin e patundur dhe të madh ndaj Partisë.

Një armatë e tërë, ushtri dhe rini bashkë, do të ndërtojë rrugën e Malësisë së Madhe, do të çajë malet, do të rafshojë shkëmbinjtë, për të sjellë më shumë dritë dhe begati në këtë anë.

II.

Spektori i parë zien nga kënga dhe hareja. Megjithëqë koha u prish dhe filloi të binte një vesë shiu, kooperativistët ia filluan këngës dhe valleve. Ata i këndonin Partisë, jetës së re, të ardhmes së lumtur që i pret këto krahina të largëta në skajin më verior të atdheut tonë.

Poshtë, lumi Cem gurgullon dhe nuk di si t'i presë gjithë këta njerëz. Ai nuk di pse kanë ardhur këtu në brigjet e tij.

Kantieri është gati për të pritur banorët e rinj. Në një kohë të vështirë, në mes të shiut dhe të erës, në mes të baltës së madhe, ushtarët tanë transportuan të gjitha materialet, që kantieri të ishte gati në kohë.

III.

Dhe ja, në qafë, të malit u duk kolona e parë. Kanë ardhur nga shumë krahina të atdheut tonë. Duke thyer çdo normë dhe zakon prapanik, 100 vajza dibrane u sulën, ashtu si dikur në rrugën Kukës-Peshkopi, kur rinia tregoi shembuj të lartë sakrifice dhe vetmohimi, për të ndërtuar edhe një rrugë tjetër të re. Ja dhe vajzat e Tropojës, plot entuziazëm dhe besim për të ndërtuar këtë vepër të madhe të pesëvjeçarit të 4-të. Ja, të rejat dhe të rinjtë nga Shkodra, Kukësi dhe Burreli, Kruja, Mirdita, Lezha. Më të vegjëlit midis vullnetarëve, janë nxënësit e shkollës «Naim Frashëri» të Durrësit, inisiatorët e parë për zhdukjen e zakoneve prapanike dhe bestytnive fetare. Por që të gjithë janë të vendosur se do të punojnë njësoj për të hapur rrugën. Po t'i shikosh duart e tyre, ato janë forcuar, sepse e kanë në gjak punën fizike. Sot ata kanë ardhur në Malësinë e Madhe, për të dhënë edhe këtu kontributin e tyre. Edhe të rinjtë e Rrogozhinës, ua kanë lënë shokëve të tyre ndërtimin e hekurudhës dhe vetë janë ngjitur maleve, për të hapur rrugën e re, sepse këto janë dy nyje,

dy vepra të mëdha të socializmit, dy aksione të mëdha të vendit.

IV.

Kazmat e para qitën vetëm shkëndija.
Shkëmb!

Qëndronin të heshtur para shkëmbit. Lumi poshtë gurgullonte. Tashti ai e kuptoi pse kishin ardhur këtu këta njerëz, prandaj filloi të ziente. Ju prish qetësia. Mali hijerëndë dukej sikur qëndronte mbi kokë.

«Përpara shokë!»

Oshëtima përhapet mal më mal dhe kodër më kodër. Jehona ngre njerëzit në këmbë.

Rinia çan malin!

Rinia lufton kundër së vjetrës.

V.

Hapat e para.

Hap pas hapi hapet rruga.

Buçasin zemrat gazmore. Tingëllojnë kazmat, lopatat e barominat, shpërthejnë minat.

Luftë!..

E reja me të vjetrën.

Drita me errësirën.

Thyhet graniti para forcës së rinisë.

Sikur të vinin këtu veteranët e rrugës Kukës Peshkopi, ata, të rrugës së «Dritës», heronjtë e hekurudhës, do të mahniteshin me këtë forcë, do të gëzoheshin që stafeta e tyre qëndron gjithnjë në duar të sigurta.

Qysh ditën e parë rezultate të kënaqshme në jetë dhe në punë: Shkodra do të japë koncertin e parë nesër mbrëma. Pasnesër e ka brigada e Peshkopisë, pastaj e Tropojës dhe kështu me radhë. Gjithshka me forcat e veta.

Në punë: Brigada e Shkodrës 101 përqind Burreli 100 për qind, Kukësi 108 për qind... Tropoja 80 për qind.

Dita e dytë; Shkodra 101 për qind, Burreli 110 për qind, Kukësi 180 për qind, Tropoja 118 për qind.

Ky është vrull i paparë, forca e madhe që u ka dhënë Partia rinisë dhe ushtrisë sonë.

Është gëzim i madh të ndërtosh lumtërinë me duart e tua. Unë shikoja me adhurim dhe dashuri të madhe ato duar të njoma, që rëmonin tokën shkëmb, por me zell më të fortë se graniti, sepse nër dejtë e tyre rrjedh gjaku i pastër dhe i ngrohtë i Partisë sonë sokoleshë.

NE «QYTETIN» E MALEVE

Të vështirë e kemi sa të arrijmë në «qytetin» e maleve: në rrugët që të shpien drejt tij, e ka të vështirë të kalojë dhe kafsha e ngarkuar. Ato janë të largëta, kalojnë bri përrenjsh e honesh, bri shparesh, deri sa zbresin në lugina e pësëri ngjiten.

Kujdes shokë, mos kaloni rrugës së rrahur, se nga maja e lartë e malit rrokullisen gurë! Hapet rruga e re.

Këndej hapet rrugë e re, rruga e Malësisë së Madhe. Dhe banorët e «qytetit» të maleve janë të rinj e të reja, të ardhur nga vise të ndryshme: ata zbritën nga malësia e Kukësit, e Tropojës dhe e Peshkopisë, nga malet e Burrelit, e Dukagjinit, nga Mirdita e dëshmorëve të parë të aksioneve të rinisë, nga Shkodra dhe nga vise të tjera. Dhe ata u vendosën në sektorin nr. I të «qytetit» të maleve.

Ja si ndodhi.

Vajzat e malësisë së Shkodrës do t'i shihje të veshura me fundin e zi, të gjatë deri në fund të këmbëve. Mbi kokë shamia e bardhë nxirrte në pah vetëm një pjesë të fytyrës. Nuk ishte e lehtë

që një mënyrë e tillë veshjeje të zhdukej. Dhe ditën e parë, ky fund i zi u zgjat mbi pantallonat e vullnetares: ai u mbuloi thuaj gjithë veshjen, ndërsa shamia pamjen. Fustani dhe shamia pengonin në punë.

— A asht mirë, i tha Lulja bashkëfshatares së vet, që të mbajmë, ne të vetmet, këtë veshje?

— Besa jo. Na nuk po dukemi si vullnetare. A i heqim?

Në rrugën e Malësisë së Madhe u hoqën dy fundet e para. Disa u çuditën, të tjerëve u pëlqeu ky veprim. Atëhere u mblodh organizata e rinisë dhe shtroi para të gjithëve: «A vepruan drejt Lulja dhe Mara».

Të nesërmen, shtabi i brigadës së Shkodrës nxori në qendër të emulacionit një fletërrufe, ku përhëndeteshin të gjitha të rejat e brigadës, të cilat në luftë të papajtuar me zakonet e vjetra, hoqën fundet e zeza e shamitë e kokës, duke dalë në punë ballëhapët. Në fshat, ato do të shkojnë pa fundet e zeza.

Si thue Mrikë.

Po kjo nuk ishte e gjitha. E vjetra paraqitet në fytyra të ndryshme, në sjellje, në zakone. Aty gjatë punës, ku kazma shkrepse xixa mbi gur, ku një grup vullnetarësh rrukullisnin një shkëmb në humnerë, do të rrukulliseshin edhe shumë mendime dhe zakone të vjetra.

Po t'i shihje vajzat e Rrëshenit gjatë punës, ato ende ruanin disa nga zakonet e vjetra të sjella nga krahina: dy vathë të rëndë vareshin në veshët

e tyre. Ato ngjanin si rreth prangash. Dhe ishte e vështirë t'i shkëputje ato prej andej. Aty, në punë, ato panë se ishin të vetmet që mbanin të këtilla gjëra. Dhe lindi pyetja në duhej të dalloheshin nga shoqet. Në ndihmë u erdhën vullnetarët e brigadave të tjera.

— Si thue Mrikë, a po i heqim?.

— Si mundeni me ndejë pa vathë?

— Janë shumë të mëdhej.

Kështu lindi diskutimi. Në minutat e pushimit ato u grumbulluan të gjitha bashkë dhe folën gjatë për këtë problem.

— Janë të rënda këto që mbajmë ne.

— Duket sikur na kanë lidhur me hekura.

— A po i heqim?.

Vathët u hoqën, por kjo s'ishte e lehtë.

Në shtëpitë e tyre cucat shkuan pa vathë si vargonj.

«Nuk kam ba ndonjë trimni!..»

Zef Gjoni dërgoi lajm: «U thuej atyne shokëve, nuk kam ba ndonjë trimni!».

Zefi është banor i përhershëm i këtyre anëve. Rruga e re kalon përbri shtëpisë së tij. Ai dhe shokët e tij, për shumë vjet me radhë e kanë ëndërruar një rrugë të tillë, që të mos bëjnë dy ditë në këmbë sa të zbresin në qytet. Nga dritarja ai do t'i thërrasë shoferit:

— Ej, shofer, më ruej një vend kur të kthehesh.

Që ditën e parë, Zefi doli në rrugën e re dhe u përzje me vullnetarët. Vullnetarët goditnin mbi

shkëmb, Zefi priste shkurret. Ç'do baba Zefi këtu? Atij s'i tha askush. Të birin, Markun, e dërgoi vullnetar, e tani atij nuk ju durua. Mori sopatën e filloi të presë shkurret, për t'u lehtësuar punën vullnetarëve.

Shpejt ai u miqësua me miqtë e rinj. Të nersermen ata i shkuan në shtëpi. Nuk e gjetën aty. I pritën të tjerë.

Kishte dy dhoma. Në njërin prej tyre, në dhomën e zjarrit, miqtë e rinj vunë re dy ikona. E reja e shtëpisë, e kunata e Zefit, vuri re se miqtë e drejtuan vështrimin nga ato ikona. Ajo ua kuptoi mendimin dhe buzëqeshi me dashamirësi...

Kështu u hap biseda rreth paragjykimeve. Ajo tha:

— Mungon i zoti i shtëpisë.

Një mendim të tillë e shfaqti edhe i vëllai i Zefit, se familja në malësi ka kurdoherë «nji mën të madh». Në bisedë e sipër hyri Zefi. Ai me burrëri përshëndeti miqtë e rinj, por shtangu kur ndigjoi përse po bisedohej.

— E Zef Gjoni, si thue? do t'i djegim këto?. Shoku Enver ka thënë se duhet t'i djegim në flakë të gjitha paragjykimet.

— T'i djegim! — u hodh e foli Dila, vullnetarja e brigadës së Mirditës.

— Ne i kemi djegë ka herë, tha një vullnetar tjetër.

Biseda vazhdoi gjatë. Zefi s'ishte i qetë. Miqtë e kuptuan sa të vështirë e kishte ai, por biseda e nisur duhej çuar deri në fund...

Zefi u ngrit në këmbë dhe me hapa të shpejta u drejtua nga ikonat. I mori ato dhe... i hodhi në

zjarr. Vajza e tij njëmbëdhjetë-vjeçare fërkoi duart nga gëzimi... Miqtë u përqaftuan me të zotin e shtëpisë. Zefi tha:

— Kurkujt nuk i duhet besue, veç Partisë e popullit.

Kur mori vesh se për të do të shkruhej në gazetë, ai çoi lajm:

— U thoni atyre shokëve vullnetarë, nuk kam ba ndonjë trimni.

Herë pas here, Zef Gjonin e gjen në mes të vullnetarëve.

Skena u ngrit shpejt

Frugë e re hapet në këto male. Erë e re fryn në këto male. Vullnetarëve u duhet që çdo aktivitet mbas punë ta organizojnë vetë, ndonëse mund të vinë dhe grupe artistike nga larg.

Skena u ngrit shpejt. Një skenë e thjeshtë, pa perde e pa çati, me dekorin më të bukur, pejsazhin e egër të maleve dhe qiellin e kaltërt të atdheut tonë. Çadrat e vullnetarëve u qëndrojnë mbrapa si gardh.

Del spikerja. Dhe spektatorët, të ulur mbi gur në oborr, mësojnë se grupi artistik i brigadës së Shkodrës jep për vullnetarët një program me këngë, me skeçe e me recitime nga jeta në aksion. Këto janë pjesë të lindura aty për aty, por të gjithë qeshin dhe duartrokasin të entuziazmuar.

Mbas shfaqjes, mbrëmje vallëzimi. Këtej, në oborr kërcejnë mbi gjashtëqind vullnetarë, por që të gjithë ata janë mjeshtër të vallëzimit.

Ja, disa filluan që të mësojnë që tani valle të

krahinave të tjera. Kështu zhduket ngurimi, ngadalë. Shikojmë si e lozin vallen karakteristike të krahinës së tyre të rinjtë dhe të rejat e Malësisë së Madhe, apo të krahinave të tjera.

Mbas disa ditësh, në këtë skenë u dha një koncert me pjesëmarrjen e grupeve artistike të të gjitha brigadave: kishte aty vallëtarë nga Tropoja, këngëtarë nga Peshkopia, vajza që i binin çiftelisë, të rinj që recitonin vjershat e tyre. Dhe në të gjitha këto bëhej fjalë për Partinë, për punën.

* * *

Krahas rrugës së re, që po hapet në Malësinë e Madhe, vazhdon dhe një rrugë tjetër. Në punë, në luftë me vështirësitë, kalitet një brez i tërë dhe nga dita në ditë triumfojnë mendime të reja.

Rruga automobilistike do të çojë një jetë të re në Malësinë e Madhe. Këndeje e vjetra po shëmbet nga dita në ditë.

GJËMON GRYKA E GRABONIT

— 1 —

Plasje shurdhuese ushtuan në grykën e Grabonit. Oshëtima e minave shkoi mal më mal e grykë më grykë. Plasje të tilla kaq të fuqishme nuk janë dëgjuar kurrë më parë në këto anë. Malësorët që banojnë brigjeve të Cemit, të këtij lumi të kulluar si kristali, dëgjojnë oshëtimën e minave dhe zemra u gufon nga gëzimi e krenaria. Malësia e Madhe do të ketë rrugë automobilistike. Në Selcë, në Tamarë, në Vermoshin e largët, ku ka shkelur vetëm këmba e mushkës, ku qiraja e kripës ishte më e shtrenjtë se kripa vetë, shumë shpejt do të dëgjohet oshëtima e motorëve të automjeteve. Ç'gëzim për malësorët! Duke biseduar me Pjetër Prengën, një plak 70-vjeçar, ai më tha: «Kur kaluen brigadat partizane më 1944 nëpër Malësinë e Madhe, një partizan që fjeti atë natë në shtëpinë teme, më pat thanë: «Këto male, që tani gjëmojnë nga pushkët tona për liri, pas çlirimit do të gjëmojnë nga minat. Do të vijë dita, e Pjetër Prenga, që edhe këtej të buçasin maqinat, që edhe ju, malësorët, të shihni ditë më të mira». Deri në atë kohë, — vazhdon Pjetri, — unë

s'kisha zbritur kurrë në fushë dhe s'kisha parë kurrë makinë me sy. Dhe m'u duk si çudi fjala e partizanit. Por ja, ja mrrijta ksaj dite. Të rrojë Partia dhe shoku Enver që na çliruan, na bashkuan në kooperativa, na banë si një familje dhe po na sjellin makinën!».

— 2 —

Ecim nëpër trasenë e porsahapur. Gurë të mëdhej, të coptuar nga minat janë shkëputur nga zemra e malit shkëmbor. Nga ata del tymi dhe era e dinamitit; gurë të shumtë rrukullisen tatëpjetë në humnerat e thepisura të malit të Grabonit, si ortekë dëbore. Këtu përdoren sasira të mëdha dinamiti. Por nuk janë dinamiti dhe kapsollat ato që vendosin, që thonë fjalën e fundit. Jo, rruga e Malësisë së Madhe po ndërtohet nga duart e arta të rinisë sonë heroike.

Ja, atje rrëzë një përroi duken ca shkëmbinj hierëndë, kreshta, kreshta. Majë atyre gurëve të lartë e të thepisur vetëm shqiponjat mund të qëndrojnë. Por aty duhet të kalojë traseja, sepse vend tjetër s'ka. Kush do të ngjitet?

Midis të rinjve dhe të rejave aksionistë bëhen biseda të zjarrra.

— Kush do të ngjitet?

— Ngjitemi ne — thotë Leze Bushati, komandantja e brigadës së Tropojës — jemi mësuar ne t'u ngjitemi shkrepave.

— Jo, jo, mos na koritni, o vajza — thonë vullnetarët e Kelmendit. — Neve na takon të ngjitemi, sepse jemi në vendin tonë dhe më lehtë

se ne askush nuk ka për t'i hedhë në erë ata shkëmbinj.

Midis vullnetarëve lindi një garë e vërtetë: çdo brigadë, çdo kompani, çdo i ri apo e re e ka për nder të punojë në vendin më të vështirë. Dhe gara të tilla zhvillohen çdo ditë; ata kanë marrë një hov të madh. Vullnetarët e Durrësit, të Shkodrës, të Rrëshenit, të Kukësit, të Peshkopisë dhe të rretheve të tjera, me mundin dhe me djersën e tyre, po lenë kujtime të pavdekëshme në punën për ndërtimin e kësaj vepre të madhe të socializmit.

Traseja e rrugës së re gjëmon nga minat, nga këngët, nga brohoritjet.

— Ne jemi çdo ditë si në festë — thotë Lena, një vajzë e re nga Selca, komandante e kompanisë së Kelmendit. — Punojmë boll, lodhemi boll, por zemrën e kemi të mbushur me plot gëzim. Lodhjen nuk e ndjejmë fare dhe na duket sikur dita-ditës përtërihemi, bëhemi më të fortë, më të gëzueshëm, sepse na gëzon puna.

— Kush punon më shumë? — e pyeta Lenën.

Vajza e re uli kokën dhe po mendohej.

— E kam vështirë ta përcaktoj — tha me buzëqeshje. — Njëzet e një vajza dhe njëzet e nëndë djemtë e kompanisë së Kelmendit punojnë si sokola malesh. Që të gjithë janë njëri më i mirë se tjetri. Po ju, po deshët, shkruani për këta të dy.

Një vajzë që e quajnë Age dhe një djalë që e quajnë Mark, nga Selca, sapo u martuan, erdhën vullnetarisht të punojnë në këtë vepër. «Dhe nuk ka gjë më të bukur për mua dhe për Agen time — tha Marku. — Nuk do ta harrojmë kurrë

për tërë jetën kohën që po kalojmë këtu duke punuar. Fëmijët dhe nipat tanë do të na kujtojnë me respekt e dashuni, sepse po bëjmë një vepër të madhe».

Pak më tutje po ndeshin me një shkëmb një grup të rinjsh dhe të rejash. Shkëmbi lëvizi nga vendi shekullor dhe u rrokullis tatëpjetë me zhurmë. Cilët ishin këta? Xhyhere Hoti. Ajo është një ndër 250 vullnetarët shkodranë, që ju përgjigjën thirrjes së partisë për të shkuar dy vjet në kooperativat e zonave malore. Ajo ka shkuar në kooperativën bujqësore të Letajt, në bjeshkët e Dukagjinit. Dhe së bashku, me Zoja Kolën dhe shumë të rinj dhe të reja të tjerë të këtij lokaliteti kanë formuar një kompani dhe kanë ardhur për dy muaj në aksionin e rrugës së re. Xhyherja e quan veten dukagjinase dhe lufton për t'u kthyer në Letaj faqebardhë, që kompania e tyre të zejë vendin e parë midis gjithë aksionistëve të tjerë.

— 3 —

Në të dy sektorët e rrugës së Malësisë së Madhe u përhap ky lajm: «Vullnetarët e shkollës 12-vjeçare «Naim Frashëri» të Durrësit, për nder të Kongresit të 5-të të Rinisë, vendosën ta ngrënë normën nga 1,3 metër kub në ditë në teren shkëmbor, në 1,7 metër kub. Lefteria, Lida, Mihali dhe inisiatorët e parë të këtij zotimi të guximshëm e dëshmonin me prova konkrete ngritjen e normës. Midis aksionistëve të brigadave të Durrësit, të Kavajës, të Rrogozhinës lindën shumë disku-

time. Diskutimet për rritjen e normës përfshinë të njëmijë e ca vullnetarët e kësaj rruge.

Nxënësit e shkollës «Naim Frashëri», si inisiatorët e parë që muarën këtë zotim, i hynë me guxim punës dhe duallën fitimtarë. Vjollca, një nga anëtarët e kësaj brigade, shkruan në ditarin e saj: «Vështirë e kemi ditët e para. Vendi ku kalon traseja e rrugës është gjithë shkëmb e gurë. Vende- vende, buzë Cemit, shihen humnera të thella. Një pakujdesi e vogël dhe... Po askush nuk trembet, askush nuk përkulet nga vështirësitë...»

Sot është ditë e vrërët. «Do bjerë shi sot — thotë Lida. — Hej, drej, si nuk po na ndahet ky shi i mallëkuar! Si nuk po na le të punojmë». Dhe pas pak nisen pikat e para të shiut. Vetëtimat dhe bubullimat. Tunden Leqet e Hotit nga shkrepëtimat dhe rrufetë. Ne u futëm nën ca shpella, po nuk e lamë frontin e punës. Shiu pushoi, rrezet e arta të diellit çanë retë dhe ndriçuan natyrën e bukur. Kështu e ka pranvera. Edhe qan edhe qesh. Megjithëse ra shi, norma u plotësua 1,7 metër kub për secilin anëtar të brigadës. Pati djem dhe vajza që e tejkaluan normën e re. Duhet ta realizojmë pa tjetër, se jemi inisiatorë. Nuk duhet të turpërohem. Dhe pa tjetër ne do të dalim fitimtarë».

Por ja, pas dy-tri ditësh dolën guximtarë të tjerë. Të rinjtë dhe të rejat e brigadës «Qamil Gjuzi» të Rrogozhinës e tejkaluan normën nga 1,7 në 2,20 metra kub në ditë.

Ecë e mati, pra, forcat me brigadën dy herë sulmuese të Rrogozhinës. Disa të rinj dhe të reja të zonave të thella malore thanë me ironi: «Hë, hë, janë fusharakë ata, nuk do t'ja dalin dot. Kot i hynë kësaj valleje. Nuk është e lehtë të bësh dy metra e ca më këmbë».

Por ja, të 47 anëtarët e kësaj brigade i realizojnë plotësisht normat e reja, madje shumë prej tyre, i tejkalojnë normat e reja. Brigada e Rrog-zhinës mori për të tretën herë titullin «sulmuese». Nuk ka anëtarë të kësaj brigade që të mos ketë merituar disa herë këtë titull nderi.

— 4 —

Malësorët e Brojës kanë sot në gjirin e tyre mysafirë. Në Brojë, «kooperativë e re malore në brigjet e Cemit», ka ardhur një grup aksionistësh të rrugës së re. Kooperativistë dhe vullnetarë përqafohen si shokë e miq të vjetër, shtrëngojnë duartë me përzemërsi dhe bisedojnë si vëllezër.

Aksionistët u tregojnë emrat dhe vendin nga janë. Marku u flet malësorëve të Brojës në emër të vullnetarëve të brigadës së Krujës, e cila ka marrë dy herë titullin e sulmueses. U thotë se ai dhe disa djem e vajza të tjera janë anëtare të kooperativës bujqësore të Bushneshit.

— Vërtet, kooperativa jonë është fushore — u tregon Marku malësorëve, — por edhe ne kemi hasur vështirësi. Vështirësitë i kapërcejmë me punë e sakrifica dhe po ecim vazhdimisht përpara. Të ardhurat vijnë duke u rritur. Kooperativa jonë po forcohet çdo vit e më tepër. Ne të rinjtë, në shembullin e komunistëve të fshatit, ishim të parët që përkrahëm inisiativën e kopshteve dhe bagëtive personale. Kopshtet i zvogëluam nga 3 në 1 dynym. Edhe bagëtinë, gjithashtu. Tani kooperativa do të forcohet edhe më tepër, sepse është shtuar pjesëmarrja e anëtarëve në punë; ata po lidhen

më fort me punën dhe pronën e përbashkët. Angjelina dhe Ageja, nga kooperativat e Krujës, bisedojnë me gratë dhe vajzat e Brojës. Ato i hapin zemrën njëra tjetrës dhe urojnë Partinë dhe shokun Enver, që sollën këtë ditë të mirë dhe u krijuan mundësitë të njihen e të miqësohen. Njëra nga vajzat krutane ka shfletuar broshurën ku është botuar fjalimi i 6 shkurtit i shokut Enver Hoxha dhe i lexon me fjalë të shkoqura një malësoreje nga Broja: «Dëgjo ç'ka thënë shoku Enver për gratë e vajzat e vendit tonë, i thotë ajo. «Gjithë Partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë, të djegin me zjarr e t'i këputin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave.»

Vajzat betohen se nuk do të lejojnë kurrë që të shkelen dhe të merren nëpër këmbë të drejtat e tyre. Ato dalin në fotografi dhe shënojnë adresat e njëra tjetrës, lidhin miqësi të ngushtë e të përjetëshme.

Takimi i vullnetarëve të Krujës, të Rrogzhinës dhe të rretheve të tjera me kooperativistët e këtyre anëve është bërë shkollë e madhe për shkëmbimin e eksperiencës. Nga bisedat përfitojnë edhe malësorët edhe aksionistët, sepse të dyja palët kanë nevojë për eksperiencën e njëri tjetrit.

Vullnetarët e rrugës së Malësisë së Madhe e kalojnë kohën e lirë në mënyra të ndryshme. Disa shkojnë për t'u njohur e miqësuar me kooperativistët fqinjë, të tjerë lexojnë, shkruajnë, e pre-

gatitin skeçe e kuplete të ndryshme për t'i shfaqur në mbrëmje përpara vullnetarëve. Hidajetit i ka ardhur letër nga familja. Ajo e lexon me zë të lartë dhe ve buzën në gaz. «Mos na turpëro, i shkruan vëllai i vogël. Të vish sulmuese në shtëpi. Sa të vish ti, do të nisem unë në aksion. Të shohim kush do të fitojë më shumë shenja sulmuese, ti apo unë. Ehe, kam për të ta kaluar, jam më i fortë unë». Një vajzë tjetër lexon letrën që i ka ardhur nga një shoqe e saj, e cila ka shkruar vullnetare në hekurudhën Rrogozhinë-Fier.

...Po afron nata. Muzgu i mbrëmjes errësoi majat e maleve dhe luginën brigjeve të Cemtit. Në sektorin Nr. 2 janë ndezur llambat elektrike. Ndërkohë, në trasenë e rrugës së re që tani është e heshtur, shihen disa njerëz si hije që lëvizin me shpejtësi. Djemtë që lëvizin japin sinjalin e alarmit: «Miinaat, miinaat...»

Plasje shurdhonyjëse ushtuan përsëri nga të katër anët e leqeve të Hotit. U duk për një çast sikur malet u tundën nga vendi. Zjarrmëtarët, djem të rinj dhe të shkathët, shikojnë gurët e dërmuar, thithin erën e zakonshme të dinamitit dhe ndjejnë kënaqësi.

— Nisemi edhe ne — i thotë Limani shokut të tij. — Në sektorin Nr. 2 ka mbrëmje sonte.

— Posi, posi, qysh tashti bile. Ndoshta u bëmë vonë; shfaqja do të ketë filluar.

— Jo, jo, akoma nuk ka filluar. Do të ndihej fizarmonika.

Kështu bisedonin ata të rinj guximtarë atë mbrëmje maji, gjatë trasesë së rrugës automobilistike të Malësisë së Madhe.

Pas disa minutash zjarrmëtarët arritën në qendër të sektorit Nr. 2. Atë çast konferencieri njoftoi:

— Sonte, të dashur shokë e shoqe, grupi artistik i shkollës 12-vjeçare «Naim Frashëri» të Durrësit jep këtë program të vogël artistik. Të gjitha pjesët janë hartuar nga ne, me forcat tona, këtu në aksion dhe pasqyrojnë punën tonë. E hapim programin me këngën e rrugës së Malësisë së Madhe. Vargjet janë të vullnetares, nxënëse e shkollës sonë, Naxhije Gripshi.

Dhe në brigjet e lumit Cem jehoi kënga e të rinjve durrësakë,

*Neve Partia na besoi
Një detyrë të re,
Që të hapim në Malësi
Bashkë një rrugë të re.
Mblidhen, mblidhen nga çdo anë
Vullnetarë plot.
Nisen, nisen në aksion
Me këngë në gojë.
Sa e bukur rruga jonë,
Bashkë ne e ndërtojmë,
Pa përtuar, ditë e natë,
Gjithë gëzim punojmë.*

Vullnetarët, që kanë zënë vend në një kordinë të vogël, përpara skenës së thjeshtë me batanie, ndjekin me kujdes dhe vëmendje të madhe shfaqjen artistike të shkollarëve durrsakë.

Aksioni i rrugës së re është bërë shkollë e madhe edukimi për vullnetarët. Jonuz Tershalla nga

Kukësi, Dile Paloka nga Rrësheni dhe të tjerë na treguan raste konkrete për edukimin dhe kalitjen revolucionare të aksionistëve. Ata këtu punojnë dhe edukohen me frymën revolucionare të Partisë, kaliten me vështirësitë.

Qothere Rexhepi, një vajzë e re, kooperativiste nga Mjeda e Shkodrës, është ulur mbi një gur, ka vënë fletoren e shënimeve mbi gju dhe po shkruan. Çfarë e frymëzon vajzën e re këtu midis malesh me maja kreshnike, të zbardhura nga dëbora shekullore, brigjeve të Cemit të kulluar? Mos vallë ajo u shkruan letër shoqeve dhe shoqëve të brigadës së saj në Mjedë? Apo i bën letër familjes? Apo... Jo, as njëra, as tjetra. Brigadierja e Mjedës po bën një poezi, po i thur vargje rrugës së re. Poezia e saj ishte vendosur në qendrën e emulacionit socialist të sektorit Nr. 1. Ne shënuam disa vargje. Ja çfarë shkruan Qotherja;

*Po shkojmë, po shkojmë
Të gjithë në aksion,
Rrugën e re ndërtojmë,
Në Vermosh ta çojmë*

E kështu e kalojnë kohën e lirë aksionistët e rrugës së Malësisë së Madhe. Ata punojnë, mësojnë, këndojnë. Aksioni farkëton njerëz të rinj, me mendime dhe ndjenja të reja revolucionare.

DITË E ZAKONSHME

Dita për të cilën po shkruaj, ishte ditë e zakonshme pune. Mëngjezi ishte pak i ftohtë. Secilit ju caktua vendi i punës. Atë ditë vullnetarët kishin vendosur që ta shpallin ditë sulmi.

Poshtë nesh, rruga e re binte thikë mbi shtatin e lumit. Ai është i kthjellët, por i rrëmbyeshëm. Kjo është veçori karakteristike e këtij lumi të pijshëm. Ja, këtu buzë lumit, puna kish marrë vrull. Kompania e dytë është në garë me të parën. Thomaj, Astriti, Nazmiu, Merita s'e ngrenë trupin fare. Por nuk rri pas as Vladimiri. Edhe komandanti i kompanisë së parë, Neki, është punëtor, megjithëse shumë hokatar.

Kazmat dhe lopatat ngrihen e ulen në mënyrë të rregullt.

Vendi është i vështirë: Ka shkëmb, gurë të mëdhenj... Këtu nuk mund të përdoret mina, pse afër ndodhet sektori. Kështu që do të na duhet që shkëmbin ta copëtojmë me duart tona. Dhe vullnetarët fituan përvojë në nxjerrjen e gurëve. Ja, Izet Lila, mjeshtër i nxjerrjes së gurëve. Bashkë me shokët, ai ka futur levat në shpinën e një guri të madh. Muskujt tendosen dhe guri po ngrihet lart. Një urra e fortë buçiti, kur ai u rrokullis në lumë, në fillim me përtaci, pastaj, nga buza e greminës iku me vrap.

Sa gëzim sjellin tek vullnetarët ato vrapime të gurëve drejt greminës!

Një shkëmb tjetër i madh pengon në vazhdimin e punimeve. Thirret mjeshtri i thyerjes së gurëve, Aqif Cikalleshi.

— Si të duket?.

— Do ta bëj copë-copë.

— Kujdes!. Guri është i pabesë.

Një ashkël guri goditi lehtas Thomain. E mjekuan në infermeri dhe e urdhëruan që të pushonte në çadër. Ai shkoi në punë. Kur e mori vesh mjekja, u habit:

— Ke thyer rregullin — i tha ajo.

— Ashtu është, kam thyer rregullin, por sot e kishim ditë sulmi.

Atë ditë, ne e plotësuam normën 131 për qind.

USHTARI MINATOR

Është minator. Ka disa vjet që e ushtron këtë mjeshtëri. Kur erdhi në ushtri, filloi nga puna aty ku ishte fronti më i vështirë. I shkurtër, i nxirë krejt nga dielli, pak i kërrusur, kështu e ka për natyrë të ecë, fjalë-pak. Kur i flet, të përgjigjet me atë zërin e tij të ngjirrur: Urdhëro!. Të ngjirrur, sepse përpara se të ndezë minat, ai do të bërtasë: «Minat!... Minaaaaat!»

Dhe zëri i Behar Grishtës, kështu e quajnë ushtarin minator, njeriun e palodhur, të vemendshëm, ushtarin e kujdesshëm dhe të disiplinuar, të dashur me të gjithë që punon së bashku me shokët e tij, buçet në rrugën e Malësisë së Madhe.

Atë e shikon kurdoherë bashkë me grupin e ushtarëve. Behari në mes, ata rreth e qark tij. Vetë puna e ka nxjerrë atë në krye të grupit. Shokët e ndigjojnë, i binden, e nderojnë.

* * *

E shoh Beharin dhe shokët e tij tek po ndihmojnë një grup vajzash dibrane.

— Ju, shoqe, u thotë ai, këtu edhe këtu do të hapni fernella për mina.

Pastaj ai vetë fillon nga puna, i mëson ato si të mbajnë barominën, si t'i bijen me vare, dhe sa duhet të hapet vrima.

Si mbaron me to, ai shkon më tutje, atje ku punojnë vajzat e Tropojës, të rejat dhe të rinjtë e Shkodrës, të Lezhës, të Burrelit.

Kudo e gjen Beharin: mësues dhe këshilltar. Ai është mjeshtër i profesionit të tij dhe mundohet ato që di, t'ua japë dhe shokëve të tij më të rinj, edhe vullnetarëve që s'kanë kapur kurrë vare me dorë.

Nga mëngjezi në mbrëmje, atë dhe shokët e tij i gjen në këmbë.

* * *

Një cilësi e rrallë e karakterizon Beharin në punë: ndjenja e lartë e përgjegjësisë për punën e tij, për detyrën si kryeminator, për detyrën si anëtar i Bashkimit të Rinisë së punës të Shqipërisë, për shokët në radhë të parë dhe për gjithë materialet që ka në përgjegjësi: lëndën eksplozive, kapsollat, fitilat.

Behari është i kujdesshëm:

— Minatori gabon vetëm një herë, — u thotë ai shokëve. — Po të jesh i kujdesshëm, të kesh mëndjen, të mbrosh shokët dhe veten, ky është profesion i mirë.

Ai punën e fillon mbarë që në fillim: kontrollon kapsollat, i pregatit, me kujdes merr lëndën eksplozive dhe, mbasi ikën vullnetari i fundit nga rruga, fillon nga puna për mbushjen e vrimave. Punon ngadalë, duke i menduar të gji-

tha gjërat gjer në hollësitë më të thjeshta: mbushjen e rregullt, ndezjen e shpejtë, sigurimin e vendit të minuar, sigurimin dhe strehimin e minatorëve. Si i ka bërë të gjitha gati, ai u bërtet shokëve: «Nisuni! Me vrap». Vetë largohet i fundit dhe megjithëse mund të jetë më i shpejtë se ndonjeri nga shokët, ai s'e kalon, por i rri mbrapa dhe e nxit të shpejtojë.

* * *

I tillë është Behar Grishta, minator në rrugën e Malësisë së Madhe, ushtar, anëtar i Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, që punon pa u lodhur në këtë aksion të madh të ushtrisë dhe të rinisë sonë.

Beharin e duan të gjithë, e nderojnë dhe e respektojnë, sepse ai, me të gjitha energjitë e tija, i përgjigjet vrullit të ri revolucionar, që karakterizon ushtrinë tonë.

FI—LI — POK!

E thërres nga donjëherë me të qeshur Filipok. Ai nuk zemërohet, po qesh me gjithë shpirt. A e di?. Ai qesh çiltër dhe punon pa hile. Ka gjoks të madh e duar muskuloze. Mua më pëlqen ta shoh tek qesh dhe përsëri vazhdoj mësimin tim metodik, si përpara nxënësish:

— Goja hapet tri herë: Fi-li-pok!

Po ja, tani Filip Goreja është serioz. E shoh tek e kap varenë me ato dy duar të fuqishme dhe qëllon mbi shkëmb, «bamb-e-bamb-e-bamb!». Në ballin e gjërë i duken ca bula djerse. Ai vështron gurin e copëtuar, pa pyetur për mësimin tim metodik.

Filipokun e duan të gjithë shokët. Ai ngjan me një farkëtar të vërtetë: godit me vare mbi levën tek hap vendin e minave, copëton një gur, shtyn me shokët një copë shkëmbi të madh në greminë, fshin djersën dhe...

— Goja hapet tri herë: Fi-li-pok!.

Dhe ai qesh. Dhe të tjerët qeshin. Të gjithë e ndjejnë veten shumë të gëzuar.

Të dielave, në lumë sheh shumë vullnetarë: dikush lan, një tjetër ngroh ujin, një i tretë shku-

mëzon teshat, e Filipoku... Kush e merr vesh ç'bën ai!?

Filipoku po lan çarçafët vetë. Po se mos i lan vetëm ai çarçafët! Të gjithë i lajnë çarçafët, dhe drutë nga mali për të nxehur ujin po vetë e zbresin. Por, veç Filipokut! Ai si rrobalarës i mirë, u tregon të tjerëve se i janë zbutur kallot nga uji dhe duke i fërkuar teshat mbi gur.

Mua më vjen për të qeshur dhe thërras tërë gaz për shokun tim:

— Goja hapet tri herë: Fi-li-pok!

Shokët e mi qeshin, bashkë me ta edhe Filipoku.

FLETË DITARI NGA NJË DEMBEL.

«Jam një vullnetar. Emrin tim, me që e dinë të gjithë vullnetarët e sektorit (dhe çuditim, si e kanë mësuar për të keq!), nuk po e shënoj.

Ditët për mua kalojnë me të njëjtin ritëm. Në orën 5 dëgjohen të shtëna topash (e kam fjalën për të goditurat e çangës) dhe unë, me të dëgjuar këto të shtëna, mbuloj kokën me batanie, po shokët më tundin që të çohem. Atëhere unë bëhem grusht dhe nxjerr ndonjë psherëtimë si i sëmurë. Të them të drejtën, gjimnastika e mëngjezit, veçanërisht këtu, nuk më pëlqen. Më prish rehatin, or vëlla, më heq 15 minuta gjumë dhe kjo është e tmershme, pse, helbete, gjumi të rrit (është e vërtetë, jam dhe i vogël: 16 vjeç edhe pak dhe, plot 170 cm.); prandaj arsyeto vetë, i dashur lexonjë, dhe më qaj pak hallin.

Kur bie çanga për të ngrënë mëngjezin (ah, sikur të binte gjithë ditën!) unë çohem, mezi gjej rrobat, bile një mëngjez një këpucë e gjeta jashtë çadrës (se siç duket e kishin ngatërruar shokët nga nxitimi), vishem, marr gavetën dhe, papritur të vihem në radhë, ze një vend nga fillimi i tavolinës dhe pres (nga zori, nuk është ndarë gjella). Kur

vijnë të tjerët, e zgjas 3-4 herë gavetën. Një gavetë e marr me vete në punë.

Një herë, mëngjez ishte, nga fillimi i mensës ku rri unë, pashë një grumbull me bukë që kish tepruar, disa tavolina larg dhe, prapë, si ndonjë grykës (do të thoni ju), po jo, unë jam me shumë oreks gjatë gjithë ditës, u sula andej. Por ah, mor vëlla, se kush më pa e sikur kushedi ç'kisha bërë, më nxorën FLETË-RRUFE...! Mua, ta pret mendja, s'm'u prish aqë qejfi por... edhe sikur nuk është mirë të dalësh në to.

Pasi marrim veglat dhe vihemi në rresht, nisemi për në vendin e punës.

Sa fillojmë, unë marr një kazmë dhe... punë, o punë!. E ngul një herë «bamb» dhe 5 minuta pushim. Kështu kalojnë katër orë dhe, në pushimin e madh, përfundoj ç'kam në gavetë. Pastaj mbështetem pak të prehem, por (sa të liq!) të lënë shokët?... Ata përnjëherësh të zgjojnë dhe t'i humbasin gjithë ëndërrat e bukura që ti mund të ishe duke parë. «Marsh, në punë,» thonë ata dhe qeshin.

Porsa jepet sinjali i mbarimit të punës (i qofsha falë), kthehem në sektor. Pa larë duart dhe gavetën (or nuk shkoj as në çadër), — përnjëherësh sulem në mensë. Si gjithmonë, unë në krye të tavolinës...

Mbasi ha drekën, shkoj në çadër dhe shtrihem të fle. Kur vijnë shokët më çajnë veshët: jo kemi gara sportive, jo mbledhje e aktivitete, konkurse artistike, marshime etj, etj. (Për këto jam keq unë). Porsa boshatiset çadra, mua më ze gjumi si qengj (shokët thonë se unë gërhas, po s'e besoj).

Kështu kalojnë afro tri orë. Kur bie çanga për të ngrënë darkën, unë çohem. Besoj se e kup-toni se refleksin e çangës (e kam fjalën për çan-gën e ngrënjeve) e kam shumë të zhvilluar. Mbas darkës, gjumi më përkëdhel qepallat. Por ëndër-rat e bukura që shoh nuk më kujtohen në mën-gjez, se, më çojnë papritur, aq sa unë trëmbem.

Kjo është një pjesë e ditarit tim. Herë tjetër, ju do të mund të lexoni vazhdimin e tij. Ai ndry-shon me të parin si nata me ditën. Aty do të ren-dit një për një, se si u mblodh kolektivi, më kri-tikoi, më nxori dhe një fletërrufe dhe unë bëra kthesë.

FLETË NGA DITARI

31.3.67

Me shokë dhe shoqe të tjera do të nisem për në bjeshkët e Malësisë së Madhe, në ato bjeshkë të thinjura nga pesha e rëndë e shekujve. Atje do të shkojmë për të çarë atë zemër të vjetër, për të hapur rrugë të re.

I jap lamtumirën Durrësit dhe dal nga shtëpia.

1.4.67/.

Nga larg duket një qytet me çadra, ku do të strehohemi ne. Një lëndinë e vogël, gjelbëroshe në breg të lumit Cem.

3.4.67

U hodhën kazmat e para. Puna për të gjithë ne është një gëzim i madh. Ne do të punojmë në një zonë kufitare dhe kjo e bën më tërheqëse jetën tonë në aksion.

4.4.67

Këtu çdo gjë u bëka me rregull dhe në temp

ushtarak. Çohemi në 5 të mëngjezit dhe, si ushtarët, fillojmë gjimnastikën e mëngjezit. Mbase paraqitet forca, në rresht, shkojmë në mensë për të ngrënë mëngjezin. Në orën 7 fillojmë nga puna.

7.4.67

Bie shi dhe fryn erë. Natyra është egërsuar. Ajo na pengon të punojmë sot. Në fytyrat e gjithë shokëve dhe shoqeve të mi vërej dëshpërim. Si të mos punojnë sot?.

Në mbrëmje, Sanijes i uruam ditëlindjen.

8.4.67

Sot dita lindi shumë e bukur dhe ne jemi të gëzuar që do të punojmë.

Puna fillon me vrull. Por nuk kaluan shumë dhe filluan ca pika shiu. Vullnetarët nuk e lanë frontin e punës. Normën e realizuam 110 për qind.

9.4.67

Lumi gjelbërosh gurgullon dhe na fton t'i afrohemi, për të larë duart, këmbët, gavetat, teshat. Çdo gjë duhet ta bëjmë vetë. Dhe lumi bëhet shok me ne.

10.4.67

Në çadër ja kemi shtruar një bisede. Dafina si komike, filloi nga të vetat. Ne qeshim sa mundim. Por me qënëse ishim të lodhura nga puna, fikëm dritën dhe ramë për të fjetur.

11.4.67

Në sektorin tonë erdhi grupi i brigadës së Shkodrës dhe na dha një program të vogël artistik. Ai Jaku na bëri për të qeshur me ato skeçet e tij të bukur nga jeta e aksionit.

13.4.67

Komandanti i sektorit na kritikoi, mbasi nuk e kishim pastruar mirë teritorin. Kështu u detyruam ta fillonim edhe një herë nga e para.

15.4.67

Gëzim i madh: Kompaninë tonë e shpallën sulmuese.

Nata zbret e qetë. Hëna lart në qiell qesh. Qeshin dhe gjithë yjet përreth. Qeshin të gjithë vullnetarët të mbledhur grupe-grupe. Ata do të bëjnë që të lulëzojnë këto male.

16.4.67

Rreshtohemi para flamurit. Jepen rezultatet 15-ditore të punës. Vendin e parë në garë e zuri brigada e Rrogozhinës, të dytin brigada e Krujës. Shumë vullnetarë vunë «S»-t e para.

17.4.67

Ditë sulmi. Vendosëm të punojmë më mirë. Punojmë, punojmë pa pushim. Kazmat futen thellë, lopatat pastrojnë vendin, shkëmbinjtë rrokullisen në greminë. Shikoj shokët që punojnë dhe s'di pse më kap një ngazëllim, një dëshirë për të pu-

nuar sa më shumë. Unë dhe shoqet e mia kryejmë një detyrë të madhe, të shenjtë. Kjo na shton forcat për të punuar pa u lodhur.

Rezultatet e punës ishin edhe më të mira nga dita e kaluar.

18.4.67

Shkuam në sektorin e parë për të zhvilluar një ndeshje miqësore volej-bolli.

19.4.67

Mbas 19 ditësh pune të parreshtur, brigada jonë mori flamurin e sektorit. Për këtë arsye në mbrëmje dhamë një program të pasur artistik.

22.4.67

U habitëm pa masë, kur morëm vesh se po vinin maturantët e shkollës sonë. Ata na prunë shumë gjëra të reja nga Durrësi. Ata vunë re se ne ishim shëndoshur që të gjithë.

25.4.67

Për nder të ditës së armës të sigurimit, atë ditë e shpallëm ditë sulmi.

26.4.67

Puna ka dhe vështirësitë e veta. Përpara na dalin shkëmbinj të mëdhenj që duan të na pengojnë. Por ne s'mbrapsemi. I thyejmë ata.

Një gur i madh ka zënë rrugën. Mundohemi ta shtyjmë, por ai s'luan vendit. Atëhere na vjen në

ndihmë Rapua dhe komandanti i brigadës së Krujës. Me forca të përbashkëta e rrokullisim në humnerë.

28.4.67

Koha e vrerët nuk na gëzon, sepse e dimë që ajo do të na pengojë në punë. Dje normën e realizuam 115 për qind.

30.4.67

Sot do të përcjellim mësuesit tanë, të cilët punuan një muaj bashkë me ne. Ata ishin mësues dhe komandantë të zotë për organizimin e jetës dhe të punës këtu në aksion. Ata punuan me të gjitha forcat e tyre, duke mposhtur të gjitha vështirësitë.

1.5.67

Mëngjezi i 1 Majit hapi dritaren e tij plot me lule shumëgjyreshe.

Mirëmëngjez, Shqipëri! Mirëmëngjez, o ju male kreshnike! Gëzuar festën ju punëtorë të palodhur të socializmit.

3.5.67

Kishim përgatitje ushtarake: mbërthim dhe zbërthim i pushkës.

5.5.67

Përpara lapidarit, kujtojmë dëshmorët e rënë, luftën e tyre legjendare për çlirimin e vendit. Ata na kujtojnë se liria fitohet me gjak.

10.5.67

Sektori i punës na ka rënë mjaft i vështirë, por ne punojmë pa pushim.

Në sektor erdhi shoku Qazim Kapysizi, i cili na zhvilloi një bisedë shumë interesante.

11.5.67

Sot çohem më e gëzuar se çdo ditë tjetër. E dini pse? Sot unë mbush 17 vjeç e shokët dhe shoqet e mia, Dervishi, Islami, Rapua, më urojnë ditëlindjen. Edhe unë do të derdh djersën time për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

16.5.67

Brigada «Naim Frashëri» e Durrësit u shpall brigadë sulmuese.

SHQIPONJAT

Përshkrim

1.

Mëngjezi i majit zbukuronte masivin e shkëmbinjeve, që quhen «Leqët e Hotit». Një shqiponjë u ngrit nga foleja. Krahët e bardhë me majat e zeza shkëlqenin nën rrezet e diellit të porsalindur. Atë kohë njëherësh me shqiponjën, në kresh-tën që vështronte verilindjen, dolën disa qindra nje-rëz. Të veshur me këmishë të bardha, (po të mos e dija se ishin ushtarë, të cilët do të prisnin si me shpatë faqen prej graniti për të hapur rrugën), me siguri, nga vëndi, ku isha, unë do t'i mirrja për shqiponja, jo nga forma e ngjyra, po duke patur mirë të ngulur në tru se në ato vënde nuk ngji-tet këmbë njeriu, se në ato vënde jetojnë vetëm shqiponjat.

2.

Rrugë nuk ka, duhet të ecësh, ose më mirë të kacaviresh me kujdes. Një e rrëshqitur e këmbës do të sillte fatkeqësinë. Kështu paraqitej gjendja

ditën e parë të punimeve. Për të shpëtuar nga kjo gjendje duhej siguruar vendi, duhej hapur traseja qoftë dhe një pëllëmbë, që këmbët të nguleshin të sigurt mbi shkrep. Dhe nisi të gjëmohet vareja. Nën peshën e forcës së ushtarëve, guri i rrahur lëshonte xixa, shkëputej nga shkëmbi, rrokullisej me uturimë e, kur binte përposh në humnerë, shkërmoqej thërrime-thërrime. Ushtarët ishin të parët që u shkëputën shkëmbinjve pjesë nga trupi i tyre. Ata jo vetëm entuziazmoheshin për punën që po bënin, po e quanin për nder që ishin të parët që po zaptoun këto fortesa të pashpëtuara gjer dje nga dora e njeriut.

E ndjenin veten të kënaqur. E këtë kënaqësi ata e kishin provuar kushedi sa herë, gjatë jetës së tyre në ushtri. Ata kanë qënë inisiatorët e tërheqjes me krahë të topave dhe mortajave. duke kaluar me to lumenj, gropa, shpate e maja, në largësi mbi pesëmbëdhjetë kilometra. Ata me shokë kushedi sa herë e kanë zhdukur objektin me predhën e parë. Giokset e tyre kanë zgjuar Drinin, Bunën, Kirin mëngjezeve të janarit dhe të shkurtit, duke kaluar nga njeri breg në tjetrin, në ujin gadi të ngrirë. Janë këta që me shëmbullin personal ruajnë si sytë e ballit rregullin dhe disiplinën ushtarake.

Kuptimi i drejtë politik në nënrepartet, ku ata janë efektivë, ka dhënë një ndihmë të madhe për ta bërë ushtrinë sa më pak të kushtueshme. Ishin ata të parët që ju qepën maleve. Gumëzhinte Cukali. Fusha e liqenit, që kish qënë qendra e vrasjeve dhe e intrigave të bajraktarëve, u kthye në një vënd pjellor, që habiti tërë krahi-

nën e Shllakut. Tremijë e gjashtëqind kuintalë patate u prodhuan nga duart e tyre dhe, bashkë me drithin tjetër, jo vetëm siguruan bukën, po dhanë disa qindra kuintalë mbi nevojat. Në vitin 1966 ata prodhuan zarzavate që të mbulonin dhe konsumin e vitit 1967, kurse në blegtori siguruan disa dhjetra kuintal mish mbi furnizimin vjetor.

Këto veti të bukura revolucionare janë shfaqur dhe në drejtim të vetëmohimit dhe të sakrificës. Sa heroik është akti i ushtar Frederik Hoxhallit, ushtar i së njëjtës njësi, që për të ruajtur pasurinë ushtarake nga zjarri, pa marrë parasysh flakët që mund t'ja mbyllin sytë përgjithmonë, u hodh mbi to dhe i shoi. Sa heroik është akti i ndërlihdësave, i Zylyftarit, i Ilisë dhe i Piros, që nën shpërthimet atmosferike, në një ambient mbytës, të goditur nga rrufetë dhe gadi në agoni, nuk luajtën nga vendi, po mbajtën ndërlihdjen të paprekur gjer sa u erdhi ndihma. E sa akte vetëmohimi e sakrifice ka në njësinë ku bëjnë pjesë këta ushtarë.

Ja, tani nënrepartet e kësaj njësie po përleshën në «Leqet e Hotit». Janë të sigurt se betejën do ta fitojnë, ashtu si kanë fituar kaq e kaq beteja më parë.

3.

Dielli ishte në të perënduar. Gjithshka ishte përflakur. Ushtarët po ktheheshin nga puna. Fytyrat e tyre ishin të zymta. Kuptohej se kishin një shkak që i brente përbrënda. Ishte dita e dytë që po punonin dhe rezultatet ishin të pakënaqura. Posa mbërritën në fushim, organizuan mbledhjet.

për të analizuar punën e ditës. Të gjithë shfaqën mendim se duhej ndërruar metoda, duhej një riorganizim i ri në gjithë procesin e punimeve. Këto propozime të ushtarëve i mori përnjëherë parasysh shtabi i punimeve dhe, në mbledhjen e bërë me komandantët dhe komisarët e nënreparteve, diskutoi mbi këto çështje dhe vendosi që të mesërmën të ndiqej një metodë tjetër. Dhe ja, dita e tretë i gjeti ushtarët më ndryshe nga të tjerat. Çdo ushtarak kish në mendje fjalën e sekretarit të komitetit të partisë, që ta konsideronte veten se kryente një detyrë me të vërtetë luftarake, ndaj duhej të ishte i rregullt dhe i përpiktë në të gjitha veprimet. Në gjithë trasenë e hapur thuaj se punonte vareja. Në shkëmbinj vrima dhe furnella të thella. Dhe kazma, lopata, qysqia nuk kishin ngelur prapa, po tingulli i varesë që binte mbi kokën e levës sikur dëgjohej më shumë. Në orën njëmbëdhjetë u dëgjua një bori. Të gjithë lanë punën. Çdo nënrepart i mbloshi veglat në një vënd dhe u nisën për në shpatin të veshur me drurë, si nja pesëqind metra larg sektorit. Atë kohë sekretari i komitetit të partisë u dha dorën oficerëve A. Ibrahimimi dhe M. Pero, duke i porositur që të përqëndronin gjithë vëmendjen për të kryer një punë me të vërtetë të dobishme. Vëndin e ushtarëve e zunë minatorët të udhëhequr nga oficerët e lartpërmendur. Posa nënrepartet mbërritën në vëndin e duhur, sikur të kishte mbirë nga honi, u duk grupi i furnizuesve. Duke mbajtur kazanët me gjellë në shpinë dhe thasët me bukë në krahë dhe duke ecur këmbadoras, grupi i furnizuesve arriti jo vetëm në orën po dhe në minutën e caktuar, në vëndin e

shpërndarjes së gjellës. Të gjithëve ju bë qejfi për këtë përpikmëri. Sekretari i komitetit të partisë u kënaq.

— Ju lumtë, o trima, e keni bërë si burrat sot, — u tha me të qeshur.

Ushtarët filluan të hanë drekë, po dukej se mëndjen e kishin te minatorët, te shokët e tyre që po armatosnin shkëmbinjtë. Pasdreke ushtarëve ju shpërndanë gazetat. Ata lexonin, po mëndjen gjithmonë e kishin te minatorët. Shpeshherë pyesnin.

— Sa është ora? Dhe sa minuta duhen?

— A do të arrijnë në kohë të bëjnë plasjen?
— sikur pyeste secili në heshtje.

Në orën dymbëdhjetë pa pesë minuta jehuan tingujt e borisë. Të gjithëve u qeshi nuri. Atë çast, nga të katër anët ushtuan zërat: «Mina! Mina!» Akrepat e sahatit lëviznin dhe, kur të dy u takuan në numrin «12», gjëmoi vendi. Nga gjokset e ushtarëve shpërthyen «Urra» të forta. Shpatet e veshura me pemë, përposh sektorit me siguri që kanë provuar shiun, borën dhe breshërin, po breshër predhash të madhësive të ndryshme provuan vetëm atë mesdite maji. Dyqind e pesëdhjetë plasje krijuan të tillë gjëmim të vazhdueshëm, të paparë, në ato themele të shkëmbinjve viganë. Gjëmimet e minave të ushtrisë i pasuan ato të minave të vendosura nga dukagjinasi, që punonin në të majtë të tyre, e më vonë ato të vullnetarëve të rinj, që çanin shpatin përposh, në drejtim të Kelmendit.

Posa u dukën minatorët, sekretari i organizatës-bazë të një nënreparti propozoi që, për nder

të punës së minatorëve, të shpallej ora e sulmit. «Urra» — të e pranuan këtë propozim. Dhe kështu lindi ora e sulmit, që shpallej çdo ditë për nder të repartit që kish rezultate më të mira.

Ushtarët u sulën në vendet e punës së tyre, gadi me të rendur, u qeshte syri. Minat kishin bërë një punë të madhe. Rrokullisej reshma shkëmbore, guri i stërmadh dhe s'donin t'ja dinin në se kishin përpara lisa apo mulleza. Ata shtypnin dhe shkelnin çdo gjë që gjenin përpara. Kish të tillë që e ndalonin vrapin vetëm kur binin në ujin e kulluar të lumit Cem.

Koha kaloi, po ushtarët nuk e ndjenë. Kur ra boria që të linin punën, u habitën. Donin të vijonin, po rregulli duhej zbatuar. Ata dinin se vendin e tyre do ta zinin përsëri minatorët, për të ripërsëritur plasjet e drekës, që të nesërmen të kishin me çfarë të merreshin.

Ushtarët nisën rrugën e fushimit. Fytyra u qeshte. Ishin të kënaqur. Ndjenin se atë ditë i kishin dhënë atdheut. Partisë, popullit atë që duhej të jepnin në detyrën që u qe ngarkuar. Nuk kishin mbërritur akoma në vendin e fushimit, kur dëgjuan gjëmimin e minave që patën vendosur shokët e tyre.

— Përshëndetje minatorëve — thirri dikush nga mezi.

Urraja shpërtheu valë-valë gjatë rrugës që ecnin ushtarët, ajo u përplas pas shkëmbinive dhe jehoi e madhërishme në gjithë grykën e Kelmen-dit.

Të pestën ditë, te Leqet e Hotit traseja ishte hapur në tërë gjerësinë e saj. Ajo kish zaptuar shkëmbin dhe e kish futur në një kular, që nën rrezet e kuqëremta dukej si një kular i zjarrtë. Kjo ishte copa e parë e rrugës, po në «Leqet e Hotit» ka shumë copa për të hapur. Unë i kam shetitur të gjitha rrugët automobilistike të Shqipërisë. Para «Leqeve të Hotit» nuk është gjë Salaria, Llogaraja, Qafa e Krabës, Qafa e Shtamës dhe Qafa e Thanës. Kur shoferët dhe udhëtarët do të kalojnë nëpër faqet e këtyre shkëmbinive fantastikë, do të falënderojnë nga zëmra «shqiponjat», të cilave u dha zëmër Partia, shoku Enver.

Faint, illegible text, possibly bleed-through from the reverse side of the page. The text is too light to transcribe accurately.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

	Faqe
Edhe malet u zgjuan <i>Mensur Hako</i>	3
Letër: «I dashur shoku Enver!» <i>Vullnetarët e rrugës së Malësisë së Madhe</i>	5
Ju përshëndesim dhe ju ftojme në garë. <i>Vullnetarët e rrugës së Malësisë së Madhe</i>	8
Ju përshëndesim dhe solidarizohemi me garën. <i>Vullnetarët e aksionit të hekurudhës së rinisë Rrogoshinë-Fier</i>	10
Kongresit V të rinisë <i>Sali Mani</i>	13
Kënga e rrugës së Malësisë së Madhe. <i>Naxhie Gripshi</i>	14
Këngë fitimtare <i>Lumira Berati</i>	15
Bri rrugës së vjetër një rrugë e re <i>Naxhie Gripshi</i>	16
Dëgjo, o Cem! <i>Luljeta Muço</i>	17
Kështu e filluam ne <i>Sami Rubi</i>	18
Gëzim të madh ka sot Malësia <i>Leze Bushati</i>	19
Rruga e re <i>Lumira Berati</i>	20
Rruga e Malësisë së Madhe <i>Diell Ndue Volaj</i>	21
Lum e lum për ty, Parti! <i>Tom Ded Mokaj</i>	23
Valët e Cemit <i>Zoica Mitrushi</i>	24
Ndër këto male të Malësisë	25
Beteja me shkëmbin <i>Sami Rubi</i>	27
Bri rrugës një lapidar <i>Nexhmie Tahiri</i>	28
Duart me damarë <i>Luljeta Muço</i>	29
Në Malësinë e Madhe <i>Miaser Fani</i>	30
Lamtumirë <i>Sami Rubi</i>	31
Ecën një malësor <i>Nexhat Tufa</i>	32
Shkatarraqi <i>Shpëtim Doda</i>	33

Dembelit	<i>Lefter Shuka</i>	35
Gjithmonë kështu na ardhtë pranvera!	<i>Luçte Doçi</i>	36
Ditët e para	<i>Mensur Hako</i>	43
Në qytetin e maleve	<i>M. Hako — L. Papa</i>	47
Gjëmon gryka e Grabonit	<i>Jani Toçka</i>	53
Ditë e zakonshme	<i>Latif Kumbo</i>	63
Ushitari minator	<i>Mensur Hako</i>	65
Fi-li-pok	<i>Eli Dhima</i>	68
Fletë ditari nga një dembel	<i>Xhorxhi Nerënxa</i>	70
Fletë nga ditari	<i>Vjollca Hasani</i>	78
Shqiponjat	<i>Reshat T. Nepravishta</i>	79

42488